KUSHTRIM HALILAJ

ZËRI QË S'U FIK

Përjetime
Kujtime
Analiza studimore

Biblioteka
Oaza e leximit

Për botuesin
Xhemë Karadaku

Redaktore
Lumnie Thaçi-Halili

Përgatitja kompjuterike
URAdesign

E-mail
ura.books@gmail.com

KUSHTRIM HALILAJ

ZËRI QË S'U FIK

Përjetime - Kujtime - Analiza studimore

Shtëpia Botuese URA
Prishtinë, 2025

Hyrje

Ky libër është një udhëtim të cilin nuk e zgjodha vetë. Filloi kur isha fëmijë, në kohën kur lufta erdhi mbi shtëpinë time, mbi fshatin tim, mbi gjithë vendin tim. Atëherë nuk e kuptoja se çfarë po ndodhte, ndieja vetëm frikën që ma mbërthente trupin, zërat e të rriturve që nuk thoshin gjithçka.

Kujtimet e asaj kohe janë të gdhendura në mua: ikja, rreshtat e njerëzve që largoheshin drejt kufirit, sytë e mbushur me frikë dhe lodhje, dhimbjet që nuk gjenin gjuhë...

Ky libër është rrëfim i një dëshmitari, jo me sytë e historianit. Është një temë që shpesh me bie ta rrëfej edhe te të tjerët, sidomos te gjeneratat e reja, prandaj vendosa të lirohem nga këto kujtime që të mbeten të shkruara. Jam munduar të jem sa më i shkurtër dhe i qartë, në ndonjë moment tjetër kur gjërat të kenë marr formë, mund të kthehem edhe me pjesën e tretë.

Kam dashur të tregoj jo vetëm historinë time, por edhe rrëfimet e të tjerëve, të atyre që u larguan në vende të ndryshme, të atyre që qëndruan, të atyre që morën armët në dorë dhe të atyre që rezistuan me protesta, nëpër institucione, me fjalë. Sepse lufta nuk ishte vetëm përjetimi i një familjeje apo i një fëmije,

ishte një përvojë e tërë e popullit që u përpoq të mbijetonte dhe të mos humbiste dinjitetin.

Ky libër nuk është shkruar vetëm për të kujtuar, është shkruar për të mos u harruar ajo që ndodhi. Lufta la plagë që ende nuk janë mbyllur, njerëz që ende nuk janë gjetur, dhimbje që ende nuk është shëruar. Dhe nëse fëmijët e sotëm e lexojnë dhe u duket e pabesueshme, atëherë kjo dëshmi është edhe më e nevojshme.

Ky është rrëfim personal. Është kujtesë dhe pyetje njëkohësisht. Është dhuratë për ata që nuk folën kurrë, dhe për ata që ende e kërkojnë veten në pluhurin e së shkuarës.

Nëse ky libër të prek, atëherë nuk është vetëm i imi, është edhe i yti.

PJESA E PARË

LUFTA NË SYTË
E NJË DHJETËVJEÇARI

Para se të fillonte lufta

Para se të fillonte lufta, shtëpia jonë ishte e mbushur me zëra që qeshnin ndonjëherë kot, ndonjëherë për ndonjë kujtim.

Në oborr gjithmonë kishte lëvizje, topa që rrokulliseshin, hapa të vegjël që përziheshin me erën. Unë dhe vëllai im nuk kishim nevojë për lodra, vetëm për hapësirë dhe njëri-tjetrin.

Të rriturit rrinin aty pranë, të qetë sikur çdo gjë ishte nën kontroll. Nuk flisnin shumë, asnjë zë i ngritur, asnjë shenjë që të bënte të dyshoje për ndonjë brengë. Ne luanim, ata shikonin dhe më dukej se gjithçka ishte mirë.

Herë pas here, në sytë e tyre zinte vend një mall i butë, mungesa e gjyshit tim. Ai kishte vdekur kur unë isha vetëm tre vjeç, në një aksident gjatë kthimit nga pazari, ku kishte shitur djathin. Ishte pesëdhjetë e pesë vjeç.

Më vonë mora vesh se një vit para se të vdiste e kishin përjashtuar nga puna, ashtu si shumë shqiptarë të tjerë në atë kohë. Nuk e kam një kujtim të plotë prej tij, por më rri në mendje një copëz kujtimi, një ditë kur hyri në shtëpi me bonbone në duar. Ishin për mua. E mbaj mend atë hyrje si një kujtim të vetëm.

Përballë nesh jetonte Baci Jakup, vëllai i madh i gjyshit tim. I drejtë, i përmbajtur, njeri që gjithkush e respektonte. Për mua, ai shpeshherë zinte vendin e gjyshit. Vetëm ta shihje aty mjaftonte, i heshtur, i pranishëm, dhe ndiheshe i sigurt.

Pas tij banonte Baci Mehë, më i vogli nga vëllezërit. I qetë, gjithmonë i vëmendshëm, i urtë dhe dëgjues i mirë.

Në lagjen tonë, atëherë nuk kishim shitore afër. Pazarin e bënim një herë në javë, ndonjëherë edhe më rrallë. Por edhe kur mungonte ndonjë gjë, nuk mungonte gjatë, sepse e kërkonim nga njëri-tjetri.

Shpesh më dërgonin të trokisja në ndonjë derë, me ndonjë gotë në dorë për vaj ose një enë bosh që pritej të mbushej me atë që kërkonim. Ato huazime të vogla na lidhnin më shumë. Ishim si një familje e madhe, ku askush s'kishte shumë, por askush nuk mbetej pa ndonjë gjë.

Fillimi i luftës

Në vitin 1995 isha 6 vjeç kur fillova mësimin në shkollën "Migjeni". Rruga deri atje ishte e gjatë, por dëshira për të shkuar në shkollë ishte edhe më e madhe. Më kujtohet mirë dita e parë: klasa e mbushur me fëmijë, zëra, karrige që lëviznin. Aty e takova për herë të parë mësuesin Haxhi, i cili do të na mësonte deri në klasën e katërt. Ne ishim gjenerata e fundit që ai përcillte para se të dilte në pension. Ai kishte një qetësi dhe mirësi në mënyrën si fliste, që e bëri menjëherë të dashur për ne.

Por, para se të filloja klasën e katërt, pushimet verore i kalova te dajët në Rezallë. Ishte fundi i korrikut të vitit 1998. Sapo kisha shkuar, dhe ende pa u rehatuar mirë, vura re se diçka nuk ishte si herët tjera. Njerëzit silleshin ndryshe, ani pse të qetë, me zëra të ulët, sikur të mos donin të viheshin re më shumë. Nuk kuptoja pse, por ndihesha sikur isha futur në një ngjarje që kishte nisur para meje. Qetësia nuk do të zgjaste shumë, sepse një pasdite, tezja m'u drejtua:

-Mos gaboni me hy në atë dhomë!

Kaq mjaftoi që të më ndizte kureshtjen. Kur e gjeta momentin, hapa derën. Brenda ishte një njeri i vdekur. Për pak çaste ishim vetëm unë dhe ai në atë dhomë të heshtur. Ajo ishte hera e parë që fillova të mendoja se vdekja ekziston, dhe pse gjërat ishin aq të ftohta përreth në atë vapë të madhe.

Në mbrëmje u kthyem në shtëpi. Kjo ishte shenja e parë e fatit që ofensiva e parë serbe të nesërmen nuk na zuri aty.

* * *

Kur u kthyem atë mbrëmje në shtëpi, aty gjeta Behlul Spahiun, fqinjin tonë. Kishte ardhur me familjen për t'u strehuar. Herë pas here vinin familje të ndryshme, të cilët qëndronin përkohësisht te ne, disa i njihja e disa jo.

Pozicioni i shtëpisë sonë, na bënte më të mbrojtur nga gjuajtjet që vinin nga ana e Runikut dhe pikave të tjera serbe. Ky pozicion bëhej vend i sigurt për të tjerët dhe për ne. Ajo që më tërhiqte te Behluli, ishte ajo se ai gjithmonë e mbante me vete një fletore, ku shkruante për gjithçka që ndodhte. E shihja si diçka të rrallë, një njeri që përpiqej të mos harronte asgjë. Por edhe më shumë më bënë përshtypje dy qentë që kishte sjellë me vete: Viden dhe Gjonin.

Nuk kisha ndier kurrë më parë një afërsi të tillë me kafshët. Ata dy qen ishin aq të urtë, të sjellshëm dhe shoqërues, sa më dukej sikur kuptonin gjithçka që ndodhte përreth. I ndiqja gjithandej, nuk mund ta shpjegoj atë lloj paqeje dhe gëzimi që më jepnin, të cilën nuk e kisha përjetuar më parë. Ishin ata, që për herë të parë më bënë ta kuptoj se kafshët mund të jenë edhe miq.

Behluli herë pas here kthehej në shtëpinë e tij për të parë bahçen e për t'u kujdesur për bagëtinë. Por

një ditë ndodhi ajo që e kishte pas shkruar edhe në ditarin e tij: më 20 gusht 1998 të shtënat kishin nisur nga mali përballë shtëpisë së tij, një zonë ku ndodheshin pjesëtarë të UÇK-së.

Shpesh ndodhte që veprimet nuk ishin të mirëkoordinuara. Kishte raste kur ata që hapnin zjarr ishin larg rrezikut, ndërsa më të ekspozuar mbeteshin civilët, ose të tjerë që ndodheshin më afër pozicioneve serbe. Ndonjëherë UÇK-ja dukej sikur vepronte më shumë me guxim sesa me plan të qartë dhe kjo shkaktonte edhe përçarje brenda vetë radhëve të saj. Jo të gjithë pajtoheshin me mënyrën si veprohej.

Serbët u kundërpërgjigjën dhe një plumb e kapi Behlulin në këmbë. Ai e lidhi plagën me rripin e pantallonave dhe i përgjakur arriti te ne. Behluli u bë viktimë e një veprimi të tillë, një shpërthim force pa llogari, që e la të plagosur.

E para që doli përpara ishte gjyshja ime, Nazifja. E priti, i afroi ndihmë. Babai im, Sadiku, së bashku me disa të tjerë që mbanin uniformën e Ushtrisë, mes tyre edhe axha im, Rrahimi, e përcollën për në Izbicë, te doktor Zaim Bajrami, i cili u kujdes për plagët e tij.

Pas dy-tri javësh, Behluli dhe familja e tij u larguan. Ndarja me Viden dhe Gjonin nuk ishte e lehtë. Ata dy qen u bënë pjesë e ditëve të mia. E dija që s'mund të qëndronin përgjithmonë, por s'e dija që do të më mungonin aq shumë.

* * *

Megjithatë, jeta vazhdoi. Ajo që nuk ndryshonte kurrë në përditshmëri, ishin bisedat, lajmet dhe shqetësimet për gjithçka që po ndodhte rreth nesh. Baci Mehë, gjithmonë me tranzistor në dorë, i dëgjonte lajmet. Nganjëherë me dorën e majtë e mbante pranë veshit, ndërsa me të djathtën bënte ndonjë punë të vogël. Ai na tregonte çfarë po ndodhte edhe kur nuk donim ta dinim, nuk mund ta fshihte shqetësimin për padrejtësitë.

Kishin kaluar muaj nga masakrat në Likoshan, Çirez e Prekaz dhe dhuna po përhapej gjithnjë e më shumë, fshatrat përreth digjeshin dhe ai thoshte:

-Edhe neve na vjen radha, s'ka mbet shumë kohë.

Përmendte shpesh edhe çfarë thoshin udhëheqësit e LDK-së dhe të Kuvendit të Kosovës, që: "Përpjekja e UÇK-së dhe tërheqja e forcave serbe duhet të rezultojë nën mbrojtjen e ndërkombëtarëve dhe një referendumi për Pavarësi". Por ai prapë-seprapë ankohej, se:

-Zëri ynë ende s'po dëgjohet.

Në vjeshtë të vitit '98 filloi një lëvizje. Serbia pranoi një armëpushim dhe në Kosovë hynë vëzhguesit e parë të OSBE-së për të parë nga afër situatën.

Kur i shihja veturat me ngjyrë portokalli me flamurin përpara, ndihesha sikur më në fund dikush po na shihte. Tashmë askush nuk mund të thoshte që

s'kishin parë gjë. Dhe kjo të jepte pak shpresë se ndoshta dikush do të fliste për ne.

Në atë kohë jetonim në shtëpinë e re. Të vjetrën, që e kishte ndërtuar gjyshi me gurë, e kishim kthyer në një lloj ode. Aty shpesh ndaleshin ushtarët e UÇK-së, bashkëluftëtarë, shokë e të afërm të babit dhe axhës, pushonin, flisnin mes vete ose bënin plane për veprimet e radhës. Edhe pse kishim më shumë net në terr pa rrymë sesa dritë, sapo vinte rryma, lëshonim menjëherë lajmet në TV, të kuptonim nëse kishte ndonjë shpresë, apo nëse kishte diçka që do ta ndalonte dhunën.

Aty pamë se marrëveshja nuk kishte zgjatur shumë. Në mes të janarit 1999 ndodhi Masakra e Reçakut, ku u vranë 45 civilë shqiptarë.

Fati ynë ishte që William Walker ishte aty dhe i pa vetë ato që kishin ndodhur. Ai mundi t'i tregonte botës, jo me të dëgjuar apo si thashetheme, por si dëshmitar. Dikush më në fund e pa dhe tha me zë atë që ne e jetonim çdo ditë.

Pas fjalëve të Walkerit, bota filloi të na dëgjojë. Ishte hera e parë që e vërteta jonë po dilte jashtë oborrit tonë, po dëgjohej edhe përtej kufijve, deklaratat e tij u bënë arsye e fortë, që shtynë ndërhyrjen e NATO-s më 24 mars 1999.

Vrasja e mësuesit Haxhi Beka

Ndërhyrja e NATO-s më 24 mars '99 kundër Serbisë na dha një ndjesi gëzimi se më në fund po na dilte dikush në krah. Por vetëm një ditë më vonë, serbët reaguan. Filluan të qëllonin me raketa nga Mokna, bjeshkë që gjenden afër Istogut.

Atë mbrëmje unë kisha fjetur në sallon, ishte ai gjumi i ëmbël që shpesh të zë para se të thërrasin të shkosh në dhomën tënde. Por këtë herë, kur më thirrën, të gjithë ishin mbledhur me një llambë në dorë. Që kur dolëm jashtë e mbulonin llambën me dorë, s'e di nëse e bënin për të mos u dukur drita apo që të mos e fikte era.

Shkuam në shtëpinë e vjetër, përballë, jo më shumë se njëzet metra. Ajo ishte e fshehur pas një peme të madhe dhe e konsideronin si më të fortë përballë ndonjë sulmi. Axha mori një kovë me ujë për të shuar zjarrin që kishim ndezur në oborr, për të djegur mbeturinat e ditës. Ai tha:

-Një zjarr ishte edhe në mëhallën përballë, te Rizant, serbët kanë gjuajt aty. Si duket, po gjuajnë ku po shohin dritë.

Si fëmijë, nuk të tregonin gjithçka. Shumë gjëra i kuptoje nga heshtja e tyre, nga sytë, nga mënyra si rrinin, nga ajo që nuk ta thoshin. Por të nesërmen

mësova diçka që më preku në shpirt: ato gjuajtje kishin goditur shtëpinë e mësuesit tim, Haxhi Beka, të cilin e kishin vrarë, dhe më keq akoma, kishin vrarë edhe gruan e tij, të paktën kështu më thanë.

Nuk dija si të reagoja. Mami më pa që më kaploi heshtja, që isha i tronditur. Pa e pyetur, më tha:

-Ata, fëmijët nuk i prekin… ata, i kërkojnë burrat, po burrat janë në mal, janë të mbrojtur, kanë armë.

Fjalët e saj më bënë të ndihesha më i sigurt. I imagjinoja burrat tanë si mburojë, babai, axha, kushërinjtë… të gjithë ata që i njihja dhe më jepnin ndjenjën e mbrojtjes. Por diçka nuk më linte rehat. Pse e vranë edhe gruan e mësuesit? Pse e qëlluan shtëpinë nga larg, nga Mokna, verbërisht, pa ndonjë plan?! A nuk ishin vetëm burrat, ata që i kërkonin?!

Fjalët e nënës më ishin ngulitur në kokë, çdo gjë përpiqesha ta shpjegoja përmes tyre. Por brenda meje ndihesha i ngatërruar. Serbët më dukeshin të ligj. Jo vetëm sepse vranë, por sepse edhe para luftës, vinin e kërkonin burrat për në ushtri. Kur vinte makina e policisë, baballarët largoheshin nga shtëpia, nuk donin të shkonin. E pata pyetur axhën:

-Pse nuk shkoni në ushtri?

Ai më përgjigjej qetë dhe drejt kurdoherë:

-Shumë prej tyre nuk kthehen më. I marrin, i vrasin. Thonë pastaj që vdiqën aksidentalisht. Ata, nuk i duan shqiptarët.

Dhe unë si fëmijë pyesja më tej:

-Kush janë më të fortë, shqiptarët apo serbët?

Ai më shihte në sy dhe më thoshte:

-Shqiptarët janë më të fortë. Ata (serbët) janë të ligj, prandaj përdorin armët.

Që atëherë, ligësinë e tyre e lidhja me dhunën që përdornin. E kuptova, në mënyrën time prej fëmije, se nuk ishte forca që i shtynte, por frika dhe urrejtja. Prandaj qëlluan në shtëpinë e mësuesit, jo për luftë të drejtë, por për t'u bërë presion burrave tanë. Ishte një mesazh. Një kërcënim. Një mënyrë për të prishur qetësinë në çdo shtëpi.

Më vonë mësova se mësuesi Haxhi atë natë nuk ishte vrarë, por i kishin rënë raketat, disa familjarë të tij ishin plagosur, kurse ai ishte vrarë së bashku me gruan me 28 mars në Izbicë.

Momentet kur askush nuk dinte çfarë të bënte

Po atë natë, më 26 mars '99, gjithçka filloi të bëhej më e qartë dhe më e turbullt njëkohësisht. Një pjesë e njerëzve po përgatiteshin për të ikur. Disa mblidhnin sende dhe i fshihnin në dhe. Disa qëndronin të hutuar, duke mos ditur nga të niseshin më parë. Në ato çaste sytë e mi përpiqeshin të kapnin çdo fytyrë, çdo lëvizje, sikur me shpresë që dikush do ta dinte çfarë duhej bërë.

Ndihesha i hutuar, i vogël mes gjithë asaj zhurme e frike, dhe brenda meje përpiqesha të kuptoja nëse kjo ishte dita kur gjithçka do të ndryshonte përgjithmonë. Të tjerët filluan të grumbulloheshin në një shtëpi fqinje, të afërm, miq.

Tek ata shihja një përzierje frike dhe shprese, sytë e tyre dukeshin sikur pyesnin njëri-tjetrin pa zë: "Ku të shkojmë, a do shpëtojmë, kush do të mbetet pas?" Duheshin hapa të ngadalshëm, sikur të gjithë prisnin që dikush tjetër të vendoste për ta.

Nga larg dhe afër, dëgjoheshin krisma që qëllonin mbi malet përballë shtëpive, aty ku dyshonin se fshiheshin burrat.

Më kujtohet ai mëngjes kur gjithçka përreth lëvizte: bukët e nxehta në furrë, supa që zihej dhe

avulli i saj që ngrihej lart si çdo mëngjes. Para pak çastesh të gjithë prisnin ta pinin, e tani askujt nuk i binte ndërmend për të.

Secili bënte diçka. Gjyshja, me një kaci në dorë, groponte të fshihte në dhe disa sende. Na tha të largoheshim, ajo kishte vendosur të rrinte në shtëpi me stërgjyshen dhe dy kunatat e saj. Pastaj, si t'i nxiste më shumë, kushëriri, baci Rrustë, i cili doli me një flamur të bardhë në dorë dhe tha:

-Ne, pleqtë, po rrimë në shtëpi, ata, mendoj që s'kanë me na vra.

Mami i mbante rrobat në dorë, sikur as vetë s'e dinte pse. Ndoshta nga ndjenja se, kur të kthehemi një ditë, gjithçka tjetër mund të ishte zhdukur, e vetëm ato rroba do të na kujtonin që kishim pasur shtëpi.

Baci Mehë mori traktorin, jo se kishte një drejtim të caktuar ku të nisej, por nga zhurmat e gjuajtjeve dhe paniku ai u nis teposhtë, pas shtëpie, dhe i mbeti në një mezhdë are të madhe traktori. Pra, ecnim pak, ktheheshim prapë, nuk dinim ku do të përfundonim.

Atë mëngjes, pamë një turmë njerëzish që po mblidheshin në mes të një kodre, përballë nesh, afër 1-2 km, pra, shqiptarë, shumica gra e fëmijë të fshatrave të tjerë. Vendosëm të shkonim edhe ne atje, ecëm lugut të kodrës, që ishte vetëm për këmbësorë.

Sa më shumë që do grumbulloheshim atje, aq më shumë besonim se do të shpëtonim.

Baci Jakup tha:

-Mos u nisni grumbull, shkoni ka një, ka dy…

Unë, halla Sadi dhe baci Mehë ishim të fundit.

Kur u përshëndetëm me gjyshen, s'kishte kohë për përqafime. Thjesht, u pamë me një ndjenjë keqardhjeje që po ndaheshim.

Askush nuk e dinte nëse ata që iknin po shpëtonin, apo më të sigurt ishin ata që mbeteshin në shtëpi.

Por brenda nesh e kishim më të lehtë, se do t'i bashkoheshim një tufe njerëzish rreth 80-90 veta. Përderisa ne ecnim, mendja na rrinte te gjyshja. Pyesnim njëri-tjetrin: "A thua nuk vijnë… Se besoj që ju… kur t'i shohin plaka…"

Papritmas, disa plumba ranë para nesh, duke ngritur pluhur. U tërhoqëm pas, duke pritur ku do binte tjetri.

Pas një momenti, sërish vazhduam, bashkuam hapin me të tjerët. Kur mbërritëm në atë turmë, dikush tha:

-Për Zotin, kanë me na vra, po thonë që në fshatin Leqinë i ka vra UÇK-ja tri plaka serbe, e tash paskan thanë, që për çdo serb të vrarë, kanë me i vra njëqind shqiptarë.

Disa trembeshin më shumë. Një djalë, ndoshta pesë a gjashtë vjet më i madh se unë, e vuri plisin e bardhë mbi kokë dhe doli në kodër. Njerëzit i thanë:

-Çka je tu ba, more djalë? Hiqe plisin, mos tërhek vëmendje!

Ai ishte adoleshent, me një lloj revolte që s'dinte ku ta qonte. Vendosi plisin mbi kokë si për të treguar trimëri, por as vetë nuk kuptonte që mund të na bënte dëm të gjithëve. Po kur plumbat ranë në kodër, ai u zhduk i pari.

Pas kësaj, u tërhoqëm nga aty dhe vazhduam të gjithë për në fshatin Izbicë, hymë në një shkollë, atje ku ishte një grumbull edhe më i madh njerëzish.

Axha i kishte thënë gjyshes dhe dy kunatave të saja të na bashkëngjiteshin te lugu mbas kodrës, sepse serbët po vijnë në këmbë dhe po djegin gjithçka, është rrezik për to nëse qëndrojmë aty. Ato na u bashkëngjitën më vonë.

Baci Mehë u nis nga Izbica në mbrëmje ta merrte traktorin që i kishte ngecur në mezhdë, dhe nënën e tij që kishte mbetur vetëm në shtëpi, po ashtu një thes miell dhe kripë.

Në orën dy të mëngjesit, të datës 27 mars '99, ndërsa të gjithë flinin dhe gërhisnin nga lodhja, hyri një grua duke kërkuar fëmijën e saj. Shumë familje kishin fjetur ku i kishte zënë radha, pa rregull.

Gruaja e shkeli Beqirin, djalin e bacit Mehë, i cili ishte moshatar imi. Ai iu drejtua me një ton të lartë:

-A po e sheh që më shkele, kadale!

Të gjithë u zgjuan.

Dikush tha:

-Le se në mëngjes e merr djalin, çka u ba tash

Ajo u përgjigj:

-Po thonë, që në gjashtë t'mëngjesit kanë me hy shkijet me na pre.

Unë isha mbrapa shpinës së hallës, i mbështjellë e i lodhur, me sytë që mbylleshin vetë prej ditës së gjatë e barkut bosh. E vetmja gjë që doja, ishte të flija pak i qetë, pa na zgjuar askush. Zërat e tyre më vinin në kokë dhe përsëriteshin: "Kanë me na pre…"

I dëgjoja, por s'kisha fuqi as të përgjigjesha. Rrija aty, i heshtur, duke pritur që dikush tjetër të vendoste çfarë do të bëhej. Kur, pas gjysmë ore, dikush tha se duhej të ngriheshim për të ikur prapë, ndjeva që lodhja m'u bë edhe më e rëndë.

U nisëm drejt fshatit Tushilë. Atje qëndruam më 27, 28, 29 mars 1999. Këto ditë fjetëm 21 veta në rimorkio të mbuluar me llastik që mos të na lagte shiu, pasi që ato ditë binte shi herë pas here. Aty u ushqyem me thesin e miellit që kish sjellë baci Mehë.

Më 29 mars e mbaj mend kur pat ardhur natën axha, kur pothuajse të gjithë flinim. U zgjova jo si dy

net më parë, kur u ngrita nga frika, por si nga një gjumë i rëndë, ku një zë i njohur thërriste. Ishte diçka ndryshe, nuk dukej si lajm i keq. Kur e pashë që ishte në rimorkio, m'u duk sikur kishte sjellë me vete një fije shprese. Ai ishte i armatosur, i veshur me tesha të ushtrisë, në gjoks mbante të varura disa granata dore dhe armë në krah, të cilat i kishte marrë në Shqipëri. Ai s'foli shumë, vetëm na pa një nga një dhe tha, qetë:

-Mos u merakosni, jemi këtu mbrapa jush!

Fjalët e tij nuk e ndryshuan gjendjen tonë, por për një moment m'u duk sikur kishim dikë që na ruante nga larg.

Axha im u tha dy axhallarëve të tij, bacit Jakup dhe bacit Mehë se nuk duhej të vazhdonin të qëndronin më tej aty. U tha se po përgatitej një ofensivë dhe se ushtarët serbë mund të zbrisnin në fshat, aty ku qëndronim ne, dhe se një natë më parë, më 28 mars, në Izbicë, i kishin ndarë burrat dhe i kishin vrarë, por kishin gjuajt edhe bomba brenda shkollës ku kishin vrarë edhe gra e fëmijë.

U larguan bashkë me axhën në errësirë, ishte ora 03:00 e mëngjesit. Atë natë nuk kuptova krejt çka po ndodhte. Flisnin me zë të ulët, thuajse me kode, për të mos i zgjuar të tjerët. Vetëm në mëngjes, kur s'durova më pa pyetur, m'u bë e qartë pse ishin nisur. E thoshin të vërtetën si diçka që nuk donin t'i

frikësonin gratë dhe të rinjtë, që rrinin aty ngjitur njëri pas tjetrit.

Po në këtë ditë, më 29 mars, rreth orës 11 të paradites, serbët hynë në fshatin Tushilë. Në fillim gjuanin nëpër male, si për t'u siguruar që nuk ishte askush i fshehur. Aty u krijua një panik edhe më i madh, sidomos te familjet që i kishin burrat me vete. Shumë prej këtyre burrave kishin vendosur të rrezikonin jetën duke u qëndruar familjarëve pranë në ato momente kritike. E mbaj mend kur të gjithë të rriturit po lidhnin shami të bardha në kokë. Një grua e pashë teksa ia mbështillte shaminë rreth mjekrës burrit, sikur donte të mbulonte që mos të dukej mashkull. Të gjithë kishin dëgjuar se, në Izbicë i kishin ndarë burrat dhe i kishin vrarë. Pak nga pak na rrethuan serbët. Disa prej tyre ishin të veshur me rroba ushtrie, të armatosur, të tjerë me uniforma që kishin ngjyrë vjollcë të errët. Unë nuk e kuptoja mirë se sa e rrezikshme ishte ajo që po ndodhte. Vetëm kur dëgjova një grua duke pëshpëritur:

-Gratë po i kontrollojnë në qafë, nëse kanë dukat… po ua heqin me forcë. - atëherë fillova të kuptoja më shumë.

Në ato çaste, mami dhe halla më vunë disa zinxhirë të vegjël në qafë, sikur donin të më jepnin kurajë e të më bindnin që fëmijët nuk i preknin. Kur u afrua, një ushtar serb pyeti me zë të ashpër:

-Pse i keni vendosur të gjithë këto shalle të bardhë në kokë?

Një burrë u përgjigj:

-Është shenjë dorëzimi…

Ushtari foli serbisht dhe burri ia ktheu po ashtu. Shumë nuk e kuptonin gjuhën, por të gjithë prisnin të dinin çfarë u tha. Edhe unë isha kureshtar. Edhe nëse s'më përgjigjej njeri, e dëgjoja kur ia shpjegonin tjetrit.

Aty, na thanë të niseshim për Shqipëri. U nisëm në këmbë, pas dy-tre kilometër ecje nga fshati Tushilë, mami më tërhoqi çuditshëm në krahun e djathtë të saj. Ndoshta nuk isha i përqendruar të shikoja anash, por pas kësaj, ngrita kokën dhe i pashë të rriturit që shikonin vjedhurazi në krahun e majtë, ngula këmbë të shihja se çfarë po fshihej. Pesëdhjetë metra larg nesh ishin ca kufoma, nuk dukeshin që kishin tesha, prandaj gjaku i tyre vërehej më i theksuar nga larg. Një zë, si për ta shuar kureshtjen e të gjithëve, tha:

-Granata ju ka ra.

Nuk i njihnim. Vazhduam të ecnim deri në fshatin Turiqec, kur mbërritëm aty, na zuri terri. U ndamë nga kolona dhe shkuam në një shtëpi, te një mik i bacit Jakup, ku edhe bujtëm aty. Së pari u futëm në një odë të parregulluar. Disa burra bënin muhabet mes vete, nuk e di saktë çfarë flisnin, ndoshta tregonin ndonjë rast për luftën ose për rrugët ku

mund të shkonin të nesërmen. Kishin një lloj zëri të ulët e të rëndë, si njerëz që nuk e dinin nëse nesër do të ishin prapë aty, duke biseduar apo të vrarë diku rrugëve. Për ta, ato fjalë mund të dukeshin të shkurtra, ndoshta për të harruar frikën, por mua më dukeshin shumë të gjata. Prisja që të mbaronin, sepse mendoja se, kur të heshtnin, do të shpërndaheshim dhe të gjenim një vend më të mirë për të fjetur.

Para se të flija, e pyeta mamin:

-A ka bukë? - ani pse isha shumë përgjumshëm. Nuk i thashë për t'ia kujtuar, por doja të mësoja sa e uritur ishte vetë ajo, apo sa forcë i kishte mbetur. Sepse e dija që forca e saj ishte edhe ushqimi im. Pastaj u shtriva, me kokën te prehri i saj, pranë motrës e vëllait, dhe më zuri gjumi në mes të zërave që ende nuk pushonin. Pas dy orësh, dikush tha që të kalonim në një vend më të përshtatshëm për të fjetur. U zgjuam dhe na çuan në një odë gjysmë të djegur. Së paku nuk ishte beton i ftohtë, ishte e shtruar me dërrasa dhe kishte pak më shumë hapësirë për t'u shtrirë. Pas dy-tri ditësh në rimorkio, më në fund u shtrimë siç duhet, edhe pse nuk e dinim çfarë do të sillte mëngjesi.

Të nesërmen në mëngjes, më tridhjetë mars, na solli bukë nana Manë, po hanim të gjithë, kur erdhi burri i saj, Zymer Lutani. Tha shkurt:

-Hajdeni, ikim prej këtu se krejt po ikin!

Nuk e kishim të qartë se kah do të niseshim. Një natë më herët ishim ndarë nga kolona dhe nuk dinim më ku ishin të tjerët. Pas pak bisedash, vendosëm të ktheheshim në shtëpi. U nisëm në këmbë nga Turiqeci për në Kosterc. Gjatë rrugës, te shkolla "Migjeni", e takuam bacën Jakup dhe bacën Mehë, ishin kthyer edhe ata. Vazhduam së bashku, derisa po ecnim, dy kilometra para se të mbërrinim në shtëpi, në anën e djathtë e pamë një kufomë të shtrirë, ishte Kamer Spahiu. Serbët e kishin qëlluar në këmbë, nga gjakderdhja e madhe kishte vdekur. Ai ishte civil, atë e njihja. Këtu u ndjeva më ndryshe se një ditë më herët, kur kufomat i pashë në fshatin Kopiliq. Disi, sikur më parë, nuk doja ta pranoja atë që po ndodh, por tani ajo që po ndodhte ishte e vërtetë dhe e padrejtë.

Ajo kufomë do të mbetej gjatë në kokën time, edhe pasi lufta të kishte përfunduar, madje përgjatë gjithë shkollës fillore, sa herë që shkoja dhe kthehesha, më dukej se ajo qëndronte aty. E shtrirë, me tesha të zeza.

Pastaj vazhduam së bashku. Mezi prisja të kthehesha në shtëpi, qysh nga larg ndihej era e djegur, kur u afrova, pashë që hambari ishte bërë shkrumb, por gruri vazhdonte të nxirrte tym ende. Për një çast

m'u parafytyrua si fshiheshim mes ndarëseve *(preseqeve)* kur luanim fshehtas. Pastaj gjyshja, kur më caktonte si detyrë të mbushja thesin me grurë që t'ia jepja bostangjisë si kompensim për bostanet "sheqer të amël", të cilët për t'i mbajtur të freskëta i fusnim thellë në grurë. Kush do të mendonte se aroma e tymit, sa herë e ndiej, do të ma kujtonte atë kohë edhe sot.

Shtëpia e vjetër ishte djegur krejt, shtëpia e re kishte marrë flakë në katin e dytë, ndërsa kati i parë kishte mbetur pa dritare, me xhama të thyer. Disa rroba i kishin shpëtuar disa kushërinj, që kishin qenë aty rrotull kur ndodhi. Në sallon, prapa derës, varej një mantel i gjyshes. Serbët ia kishin vënë flakën, por zjarri kishte djegur mantelin dhe pastaj ishte fikur vetë. Dritaret i mbuluam me llastik dhe qëndruam edhe dy javë mes pluhurit, qelqeve të thyera dhe zhurmës së erës, si dhe gjithçkaje që kishim parë. Ishte një qetësi që nuk ngjante me qetësinë e vërtetë, ishte thjesht një pushim i lodhur, derisa të merrej vesh çfarë do të ndodhte më pas.

Pas gjithë asaj që kishim kaluar, në ajër dukej sikur kishte një shenjë shprese: nga qielli binin fletushka të gjelbra, në formë parash, që i hidhnin aeroplanët e NATO-s, vrapoja pas tyre që t'i kapja para se të preknin tokën. Ndoshta po luaja, ndoshta doja t'ju tregoja se e mora mesazhin e tyre. Në ato fletushka shkruhej në gjuhën serbe:

-Ikni para se t'ju bombardojmë!

Kështu e përkthente baci Jakup, nëse kisha arritur t'ia lexoja drejt çfarë shkruhej. Ishte një paralajmërim i hapur që Serbia të largohej nga Kosova, një kërcënim që sillte pak nga pak fundin e asaj errësire.

10 Prill - Dëbimi për Shqipëri

Pas dy javësh, më 10 prill 1999, pothuajse historia u përsërit prapë, por kësaj radhe me më shumë presion e frikë. Gjuajtjet bëheshin më të shpeshta dhe ndiheshin shumë afër. U grumbulluam të gjithë fqinjët dhe u nisëm për te shkolla "Migjeni", në fshatin Kllodernicë.

Kësaj here nuk u futa në shkollë me çantë mbi shpinë, por me një *cigér* në dorë që halla ma jepte herë pas here, ku kishte futur një pjesë të pites një natë më parë. Aty takova edhe disa shokë të klasës që kishin ardhur me familjet e tyre. Vetëm shikonim njëri-tjetrin nga larg, nuk kishte kohë për përshëndetje, sepse gjithçka ishte në lëvizje.

Brenda shkollës ishte edhe biblioteka, ku e pashë për herë të fundit mësuesin Haxhi, i cili ma dha lekturën e klasës së katërt, "Debatik" të Selman Vaqarit, dhe më tha:

-Lexoje, e pas një muaji e sjell prapë! Shkolla do të mbyllet tash shpejt, por pastaj, shpejt do ta fillojmë mësimin. - Kjo bisedë qe në fund të shkurtit '99.

Këto fjalë se bashku me lekturën më mbetën si kujtimi i fundit me të. Ndërsa shikoja bibliotekën pas shpinës, mendimet më vinin njëra pas tjetrës, për librat, për klasën, për gjithçka që mbetej aty. Nuk mund të thosha asgjë. As nuk kisha me kë të flisja,

sepse isha i kapur për dore dhe shkoja aty ku më tërhiqnin. Trupi ecte përpara, por mendja më mbeti për pak çaste te raftet e librave dhe te fjala që më tha mësuesi, i cili tani kishte dy javë që nuk ishte më gjallë.

Secili po kërkonte të vetin, që të mos ndaheshin dhe të qëndronin bashkë, sepse serbët po afroheshin me shpejtësi.

Para shkollës, aty ku çdo mëngjes rreshtoheshim, nga klasa e parë deri në të katërtën, tani ishim mbledhur të gjithë: fëmijë, gra, meshkuj, pleq. Aty qëndronin edhe baci Mehë edhe baci Jakup.

Disa burra hiqnin plisat dhe i mbanin në dorë, si me drojë. Të tjerë fusnin duart në xhepa, duke kontrolluar mos kishin ndonjë gjë që mund t'u bëhej shkak për telashe. Bacit Mehë, dikush i tha ta hidhte radion nga sqetulla, sepse mund t'ia sillte belanë. Një e nga një, i nxorën të gjitha, radiot, gjësende të vogla dhe i hodhën në një qoshe të shkollës. Kur serbët u afruan, na urdhëruan t'i ngrinim duart lart. Shumë nuk i morën seriozisht ose nuk e kuptonin gjuhën. Pastaj na thanë të niseshim për Shqipëri. Burrave që kishin traktorë u thanë të mbushnin rimorkiot me njerëz dhe të niseshin. Ata që nuk kishin traktorë i ndalën dhe i ndanë, mes tyre edhe bacën Mehë e bacën Jakup.

Nana Gjyle, stërgjyshja që ishte mbi 90 vjeç, ecte ngadalë. Një ushtar serb ndaloi një traktor duke e goditur me shkop gome (*pendrek)* në llastër dhe i tha

ta merrte. Pastaj ne vazhduam më lirshëm, sepse nuk duhej të ndiqnim më ritmin e saj.

Pas tre a katër kilometrash ecje, nuk më mbanin këmbët. Kërkova të pushoja pak. Kërkesa ime dukej e pamundur, sepse ndarja nga kolona ishte frikë për të gjithë. Të afërmit më thoshin mos të ndalesha. Isha i revoltuar me ata që ecnin shpejt. Kisha dhimbje në këmbë.

-Shumë më mirë të kishte mbetur nëna Gjylë me ne, do të ecnim më ngadalë, - u thashë.

Vendosa të ndalem vetëm. Pastaj ngrihesha, vrapoja që t'i arrija dhe sërish ndalesha. Kështu vazhdova derisa m'u mësuan këmbët.

Në fshatin Burojë na dolën përpara baci Mehë dhe baci Jakup. U gëzuam shumë kur i pamë, sepse menduam se nuk do t'i shihnim më. Kishte dalë urdhër që të mos i vrisnin.

Kësaj radhe, ndryshe nga hera e parë në mars, nuk na lejuan të pushonim. Serbët rrinin çdo dy-treqind metra, na bënin presion të ecnim më shpejt dhe qëllonin në ajër.

Më kujtohet kur në Klinë, para mesit të natës, u ulëm për të pushuar pak. Një ushtar serb, nga një grup ushtarësh, goditi tokën me këmbë dhe gjuajti me armë në ajër, që të mos ndaleshim.

Prej aty vazhduam për në fshatin Volljakë të Klinës, në një fushë pranë malit. Aty fjetëm nën pikat e shiut, derisa zbardhi dita dhe filluam ecjen tonë prapë.

11 prill - Ecja nëpër shi

Sapo filloi të zbardhte dita, u nisëm nga Volljaka. Përveç pites që kishim marrë një ditë më parë, tani po bëheshin gati njëzet e katër orë pa bukë. Ecëm drejt Gjakovës, pa guxuar të futeshim në ndonjë shtëpi, as për të marrë ujë.

Herë pas here, serbët kalonin me makinat e ushtrisë, duke kontrolluar nëse kolona po lëvizte dhe nëse dikush po ndahej. Askush nuk e merrte guximin të devijonte.

Na zuri nata para se të hynim në Gjakovë. Binte shi pa pushim.

Nuk e di si arrija të ecja, kisha dhimbje të forta në këmbë. Motra, që ishte dy vjet më e vogël se unë, kur lodhej shumë, mami e merrte pak në krahë. Vëllai, dy vjet më i madh se unë, ecte përpara. E shikoja ndonjëherë, doja ta dija se si po ia dilte.

Nuk ishte ai energjiku që vraponte me mua në oborr, kur më vinte pas për të ma lënë kilën. Tani dukej më i qetë, më i rritur, sikur u bë më i madh brenda natës.

Derisa më vinin këto kujtime, mbylla sytë për pak, i mbështetur në krahun e hallës, ashtu duke ecur. Nuk e ndjeja më trupin si më parë. Ishte sikur po ecja në një ëndërr që nuk mbaronte, ku çdo hap bëhej më

i çuditshëm dhe më larg nga unë. S'kisha më forcë të pyesja pse, as ku isha. Më dukej sikur kisha mbetur diku mes rrugës dhe një dhome që nuk e gjeja dot.

Pas shumë orësh arritëm në një shkollë të Gjakovës. Ishim bërë qull nga shiu. Secili u shtri ku gjeti vend. Kur u zgjuam në mëngjes, rrobat na ishin tharë në trup.

12 prill - Dita e zhgënjimit

Pasi ecëm për orë të tëra nga shkolla e Gjakovës drejt kufirit me Shqipërinë, aty dikush i tha bacit Mehë se, kufiri ishte mbyllur dhe nuk mund ta kalonim.

Kur e dëgjoi lajmin, nuk e mbante më veten si më parë. E pa vendin përballë, sikur kërkonte me ngulm një shteg, pastaj uli kokën me një shikim që s'e kisha parë kurrë tek ai. Kur foli, zëri i tij nuk kishte më as forcë, as ngushëllim, ishte i drejtpërdrejtë, pa asnjë përpjekje për të na qetësuar:

-Iiihhh… na duhet me shku përmes kufirit në Prizren, - tha.

Dikush e pyeti edhe sa rrugë na kishte mbetur. Ai ngriti pak kokën dhe u përgjigj shkurt:

-Sa kemi ecë deri tash, kemi me ecë edhe një herë.

Njerëzit rrotull lëshuan krahët, sikur ta kuptonin të gjithë njëherësh, se kjo rrugë nuk kishte mbarim.

Ashtu të uritur vazhduam. Gjyshja hipi në një traktor, sepse nuk pati më fuqi të ecte. Tani kolona nuk ishte e kontrolluar si më parë, mund të hulumtonim dikah për bukë dhe ujë.

Nuk e di nëse e kishim kaluar Gjakovën, por mua dhe vëllait na ishte kthyer energjia. Sikur për një moment ishim shkëputur prej asaj që kishim qenë

para luftës. Tani dukeshim si dikush që e kishte kuptuar plotësisht gjendjen ku ndodhej. Ishim më të vetëdijshëm se duhej të vepronim vetë, askush nuk do të vinte të na shpëtonte.

Të gjithë ishin të lodhur e pa zë. Me vëllain e pamë si detyrë të kërkonim ushqim nëpër shtëpitë anash rrugës. Shtëpitë ishin të zbrazura, por të padëmtuara. Pas tri a katër shtëpish u futa në njërën që kishte bukë dhe ëmbëlsira. Morëm një qese të zezë dhe e mbushëm plot. Aty, për herë të parë pas shumë ditësh, më erdhi një ndjenjë sikur ishim bërë përsëri të dobishëm, sidomos kur pamë familjarët duke ngrënë.

Tani, ushqimi nuk dukej më problem. Diku mes Xërxës dhe Krushës së Madhe, hymë nëpër disa shtëpi, kishin qenë të përgatitur me ushqim. Një ditë më herët, shumica e traktorëve kishin kaluar andej dhe u kishin thënë se kolona e gjatë me shumë njerëz është duke ardhur andej. Aty na dhanë ushqim dhe, për herë të parë, i mbushëm brinjët plot. Njerëzit në këto fshatra kishin qenë të përgatitur për t'u larguar ose për t'iu bashkangjitur kolonës sonë, nuk e di nëse prisnin një sinjal dëbimi nga serbët apo prisnin derisa ta shpërndanin ushqimin.

Në mbrëmje mbërritëm në fshatin Piranë të Prizrenit. Shtëpitë ishin bosh, ngado shkretinë. Vendi

dukej i parregulluar, ende jorganët e shtrirë, dukej nga pamja se janë zgjuar në mëngjes dhe kanë ikur. Kush e di se në ç'mënyrë i kanë dëbuar, ndoshta njësoj si neve. Aty bujtëm, nëse një natë më herët kishim fjetur në beton të ftohtë, tani aty mund të flije në një shtrat të gjumit, sigurisht po të mos ishim aq shumë njerëz!

13 prill - Kalimi i kufirit

Mëngjesi i asaj dite ishte më i lehtë se të tjerat mëngjese. Por sa më shumë afroheshim drejt kufirit, aq më shumë e rëndonim veten me mendime. Ata që i kishim lënë pas, na dukeshin gjithnjë e më larg.

Si janë tani?

A kanë bukë?

A janë gjallë apo i kanë marrë robër, ndoshta edhe i kanë vrarë?!

Këto pyetje na shoqëronin gjithë rrugës.

Kur arritëm në fshatin Zhur, aty kishte disa autobusë që i çonin njerëzit deri afër kufirit, rreth pesëdhjetë metra para se ta kalonim. Edhe ne hipëm. Si kompensim na kërkuan t'u blinim një shteg cigare. Kur zbritëm, para kufirit ishin vendosur copa betoni në formë trekëndëshi. Para secilës kishte nga një minë. Të paktën kështu na thoshin:

-Mos ecni anash, se janë të minuara.

Ndërsa ecnim në atë rrugë të ngushtë me mina, mendja ime nuk besonte se kjo po ndodhte vërtet. M'u duk sikur isha në një film që kisha parë më herët, vetëm se tani unë isha personazhi aty. Çdo hap e bëja ngadalë, me frikë se mos shkelja gabim. S'kisha më ndjenja të qarta, nuk e dija a isha zgjuar, apo ëndërroja.

Kur arritëm te kufiri, aty ishte aq ngushtë nga turma e njerëzve sa mezi qëndronim në këmbë. Secili shtyhej për ta kaluar vijën e fundit, sikur pas saj më në fund do të merrnim frymë.

Një pasaportë e ngritur lart nga dora e policit serb që dikush e kishte dorëzuar. Ai e tundi për të na treguar se të gjithë duhej të nxirrnim dokumentet. Ishim paksa të befasuar, sepse kishte ca ditë që nuk flitej për kufijtë, ku rregullat shoqërore edhe morale ishin përdhosur haptazi, na kishin thyer çdo vijë, na kishin vrarë e dëbuar. Edhe kur hynim nëpër shtëpi të huaja për bukë, nuk pyesnim askënd. Dhe tani, papritur, dikush të fliste për rregullat, duke të kërkuar dokumentet, sikur asgjë s'kishte ndodhur. Unë dhe vëllai i ndihmuam mamit të kontrollonte brenda xhaketës, mirëpo ajo nuk ishte e sigurt nëse e kishte humbur rrugës apo e kishte ende me vete. Pasi e gjetëm, ajo priti për pak se çfarë do të thoshte polici për ata që nuk i kishin.

Pas pak ai tha:

-Kaloni edhe pa dokumente, kush i ka, le t'i dorëzojë!

Mami e futi letërnjoftimin në xhep dhe kaluam, pa e ditur nëse po iknim nga frika apo thjesht nga lodhja.

Kur dolëm matanë kufirit, mendova se do të ndiheshim më mirë. E kisha pritur atë çast ditë të tëra, vetëm që të mbaronte ikja. Por sapo hodha hapat e parë, ndjeva diçka që nuk e kisha menduar më parë.

Atje s'na priti asnjë qetësi, s'kishim asnjë lehtësim. Vetëm një boshllëk i madh që më mbushi gjoksin. Ishte si t'ia pranoje tjetrit forcën dhe t'ia lëshoje vendin, atë vend që për ne kishte qenë gjithmonë i sigurt. Rreth meje, secili kishte shpërthyer në vaj në mënyrën e vet. Disa mbulonin fytyrën me duar, të tjerë qanin me zë, sikur donin të lëshonin gjithçka që kishin mbajtur brenda. Më dukej se të rriturit e dinin më mirë se unë sa e rëndë ishte ajo ditë. Në sytë e tyre pashë diçka që nuk e harroj dot, një lloj pajtimi me humbjen.

Unë i shikoja të gjithë, si për të mbajtur në mend se një ditë do t'u gjeja emër të gjitha këtyre që po ndodhnin. Në ato fytyra, e kuptova se nuk të thyen vetëm frika, as armët. Të thyen më shumë kur e pranon që s'ke mundur të mbrosh vendin ku ishe rritur, pragun ku kishe hyrë dhe nga kishe dalë, oborrin ku të dukej se asgjë s'mund të të lëvizte. Ishte një zbrazëti që s'mund ta mbushje me asgjë. Dhe më dukej sikur përtej kufirit ato vende na shikonin të gjithëve dhe na pyesnin: "Pse po ikni? Pse na latë vetëm?" Si diçka që dukeshin të pambrojtura dhe të lëna në mëshirën e kujtdo. Pa e pyetur veten, se a mund të bëja diçka për t'i mbrojtur, e pata më të lehtë të ecja pas të tjerëve. Ashtu si shumica, me kokë ulur, duke bërë sikur nuk shihnim prapa.

Aty na dolën përpara disa gazetarë. Na pyetën si ishim, çfarë kishim parë. Ajo që po ndodhte në Kosovë shihej në fytyrat tona më qartë se çdo fjalë.

Prej aty shkuam në Kukës, ku u bashkuam të gjithë. Aty ishte edhe gjyshja. Na pyeti menjëherë nëse kishim ngrënë bukë. Na tregoi që, ditë më herët, mes Xërxës dhe Krushës, dikush ia kishte dhënë dy kuleç bukë. U kishte thënë se pjesa tjetër e familjes po vinte në këmbë. Ajo i kishte ruajtur ata kuleç për mua dhe vëllain, duke i futur në çantën që e mbante varur jashtë rimorkios.

Ishte dëshpëruar shumë kur çanta iu ishte kapur diku dhe buka i kishte rënë. Këtë gjë na e tregonte shpesh, sidomos kur donte t'na kujtonte sa shumë na donte. Në këtë mënyrë e shprehte gjithmonë dashurinë e saj.

Pas një nate gjumi në Kukës, na dërguan drejt fshatit Togëz të Librazhdit, ku qëndruam nga 15 prilli deri më 24 qershor 1999.

Qëndrimi në Kampet e Librazhdit - Togëz, në Shqipëri

Pas nëntë orë rrugë nga Kukësi në Togëz, mbërritëm në orën dy të mëngjesit, më datë 15 prill. Aty na çuan në një kamp të madh. Sapo hyra brenda, nuk i shihej fundi. Njerëzit ishin shtrirë gjithandej. Kjo ishte nata e pestë që flija në vende të ndryshme. E prisja se do të ishte një vend i ndryshëm, por kurrë nuk kisha parë një sallë aq të madhe, ku të gjithë flinin ngjitur me njëri-tjetrin, diku njëqind apo njëqind e pesëdhjetë metra e gjatë. Gërhitjet vinin nga të katër anët. Për disa minuta i sodita një nga një, nën dritën e zbehtë të llambave të atyre që na kishin sjellë aty.

Ata kontrollonin ku kishte ende hapësirë. Pas pak na sollën ca dyshekë dhe jorganë të kaltër. Në fillim u gëzova, sepse nuk dallohej vend i lirë askund, thashë:

-Nëse diku tjetër do të kishte mundësi të flija vetëm me familjen time.

Por filluan të bënin një radhë të dytë. I shtruam dyshekët te këmbët e atyre që ishin shtrirë dhe lamë vetëm një korridor të ngushtë për të kaluar. Fjetëm aty.

Kur u zgjova, mu duk sikur isha në një skenë teatri. Të gjithë tashmë ishin zgjuar dhe rrinin ulur përreth aty ku kishin fjetur. Disa hanin bukë, të tjerë pinin çaj. Një grua përballë meje, sapo hapa sytë, më tha:

-Buka ka ardhë, janë tu e shpërnda. Shko merre se nuk rrin gjatë aty!

Pashë disa pjata dhe një tenxhere që na i kishin lënë ata që na sollën jorganët. E mora dhe dola jashtë nga një derë aq e madhe sa mund të hynte edhe një kamion ushtrie. Kampi dukej si një magazinë shtetërore e grurit.

Binte një shi i lehtë. Ishte e thjeshtë të gjeje ku ta merrje ushqimin, sepse dy radhë të gjata njerëzish prisnin: njëra për bukë, tjetra për çaj. Kur erdhi radha ime për të mbushur tenxheren me makarona, më pyetën:

-Sa anëtar jeni?

-Njëzet e një, - u thashë.

Mendova se po merrja për të tri familjet tona. Kur pyeta për çajin, më thanë që duhej të kisha enë me vete. Kur u ktheva, pashë aty që familjet tjera ishin duke ngrënë. Secili e kishte tenxheren e vet.

Rrëfimet e Bacit Jakup

Pas dy javësh kaluam në një kamp tjetër. Aty ishin katër kampe gjithsej, ose më shumë. Kampet filluan t'i ndanin me dhoma. Ne ishim në një dhomë me bacin Jakup. Gjatë gjithë udhëtimit ai e kishte mbajtur mbesën e tij trivjeçare mbi krah. Ai i donte fëmijët, edhe në kamp ai e ngrinte përpjetë dhe e priste prapë në duar, e qeshura e saj ia thyente zymtinë gjithë dhomës. Por kishte edhe net kur qetësohej gjithçka, baci Jakup ulej në heshtje dhe pastaj fillonte me tregimet e tij, ndoshta për të na dhënë kurajë, ose për të na treguar se edhe ai, në moshën tonë, kishte përjetuar ngjarje të tilla.

Baci Jakup tregonte kujtimet me babin e tij, Ejupin, se nga mosha tetëvjeçare, kishte përjetuar gjëra që s'do t'i harronte asnjëherë. Baci Mehë vinte nga dhoma tjetër, bëheshim bashkë dhe të gjithë dëgjonim rrëfimet e tij. Ai i drejtohej atij:

-E more Mehë, pesë javë para 24 janarit t'katërdhjetedytës, pra para se të lindje ti, baba Ejup e pat ble një cjap që t'festonin lindjen tënde. Por atë ditë erdhi lajmi që po qarkullonte prej fshatit në fshat, se Drazha Mihajloviqi kishte thënë se po vjen në Kosovë, kërdi do t'bëj, bile ku t'i gjej edhe fëmijët në djep, kam me i pre.

Ai tregon se si stërgjyshi iu kishte përgjigjur këtij kërcënimi të Mihajloviqit:

-Baba Ejup tha: "Vallahi nuk t'ka ardh qetu. Le të m'pret atje. Ballë për ballë, jo me ardhë këtu te gratë!" Ejupi kishte marrë pushkën, e kishte vënë në krah strajcën me fishekë dhe kishte dalë nga shtëpia. Pesë herë kishte qëlluar në ajër, për t'i lajmëruar të tjerët që po nisej. Ishin mbledhur edhe njëzet e pesë burra në Kosterc, u bashkuan me të tjerë në Runik dhe vazhduan drejt Koloshinit.

Baci na tregon se si Rudi dhe Sadri, kapitenë nga Shqipëria, kishin ardhur me topa të rëndë, u kishin dalë në ndihmë shqiptarëve duke e zmbrapsur Drazhën.

Ai thotë se kishin kaluar gjashtë javë, por Ejupi nuk u kthye më. Pastaj e kujton lindjen e bacit Mehë si diçka të rëndësishme:

-Isha me Isufin kur thanë se ka lind nana Gjylë, më thanë se tash u bëtë tre vëllezër, keni edhe një vëlla Mehmetin.

Baci atëherë ishte afër dhjetë vjeç, por i kujtohet mjaft mirë ajo kohë, ai tregon më tej:

-Ishim aq shumë të gëzuar për lindjen tënde, Meho. E premë cjapin dhe festuam, por njëkohësisht ishim edhe të mërzitur, sepse e dinim se Ejupi s'do të kthehej. E kishin vrarë. Sot e asaj dite nuk e dimë as eshtrat ku i ka. Pastaj mixha Rexhep na mori në shtëpinë e tij. Pas tetë vitesh, kur u bëra gjashtë-mbëdhjetë vjeç, u kthyem prapë në shtëpinë tonë. Bagëtitë na i ktheu mixha Rexhep, ashtu siç i kishim

kur u bashkuam: një palë ki, dy lopë edhe njëzet dhen. Nga ajo kohë kisha hyrë në radhë me burrat. Kisha nisur të prashis dhe të kujdesesha vetë për familjen.

Baci Jakup heshti për pak, u pa që ato kujtime e rënduan. Por nuk u ndal, më pas ai nisi të fliste për një tjetër rast që i kishte mbetur në mendje, atëherë kur kolonizimi serb përpiqej të shtrihej në të gjithë Kosovën.

Ai tregonte se gjatë pushtimit italian dhe administrimit shqiptar në Kosovë (1941-1943), e më vonë gjatë ardhjes së gjermanëve, shumë serbë kolonë u larguan me frikë se mos u vinte ndëshkimi prej popullit, se kujtesa për dhunën dhe grabitjen e tokave nuk ishte harruar.

Na tregoi për Radulin, një serb që kishte ardhur jo larg prej nesh, ishte vendosur në tokën e Dinollëve. Kishte vetëm gjashtë javë që ishte martuar, por kur nisi rrëmuja, e la gruan dhe iku, nga frika se shqiptarët do ta vrisnin. Nis e tregon ngjarjen:

-Në mëhallën e tyre kishin mbetur vetëm gratë e kolonëve. Disa burra shqiptarë, nga familja Dervishaj, kishin shkuar të merrnin një grua. Ajo e kishte mbyllur derën me shul, kur burrat u futën nga dritarja, e kapën për flokësh dhe e tërhoqën zvarrë për disa metra. Britma e saj u dëgjua në kupë të qiellit, donin ta martonin me zor. Por atëherë dolën burrat

tanë, baci Rrustë dhe mixha Ganë me pushkë italiane. U shkrepën pushkët, bam, bam, bam. E lanë gruan dhe ikën.

Po ashtu ai vazhdoi të na tregonte se, gjatë Luftës së Dytë Botërore, Kosova mori pjesë në Lëvizjen Antifashiste, ku statusi i saj në Jugosllavi nuk ishte i qartë si njësi federative.

Qëllimet e popullit shqiptar ishin më të mëdha: dëshira kryesore ishte bashkimi me Shqipërinë.

Ai thoshte se këto qëllime u shprehën hapur në Konferencën e Bujanit (31 dhjetor 1943 - 2 janar 1944), ku përfaqësuesit e ligjshëm të popullit të Kosovës deklaruan se duan të bashkohen me Shqipërinë pas luftës.

Ai është i sigurt se nuk ekziston dokument që të tregojë se shqiptarët kërkonin të mbeteshin në Jugosllavi ose të bashkoheshin me Serbinë. Megjithatë, pavarësisht kësaj dëshire, Partia Komuniste e Jugosllavisë, përmes dhunës dhe presionit, arriti ta aneksojë Kosovën në Federatën Jugosllave.

Ky vendim u arsyetua përmes "Kuvendit të Prizrenit", i cili, në fakt, ishte nën presion dhe nuk pasqyronte vullnetin real të popullit shqiptar.

Përkundër këtij vendimi të dhunshëm, e drejta e Kosovës për vetëvendosje mbeti e paprekur dhe populli shqiptar vazhdimisht i deklaroi ndryshe qëllimet e tij.

Ato ditë na dukeshin të gjata dhe nuk ecnin. Baci Jakup na mbante me tregimet e tij. Herë fliste për gjëra që kishte parë vetë, herë për ato që kishte dëgjuar nga të vjetrit e familjes. Thoshte, se këto histori duhej ruajtur, sepse nuk ishin thjesht kujtime të një njeriu, ishin copa nga ajo që ky vend kishte përjetuar ndër breza. Në rrëfimin e tij të radhës ai na foli prapë për kolonizimin, kur Serbia menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 1912, filloi të sillte kolonë serbë në Kosovë. Ai fliste për Rad-shmigiqin, serb prej Koloshini, i cili "mustaqet i kishte vesh më vesh". Ai thoshte se ua kishte zënë tokën. Por mixha Rexhep nuk u ndal kurrë, kishte shkuar andej e këndej, nëpër çdo vend ku mendonte se mund të gjente drejtësi, vetëm që mos t'ia linim tokën serbëve. Dhe ia arriti që me dokumente ta kthejë tokën. Pastaj, serbët filluan ta ndiqnin. I thoshin:

-Pse ke shku atje me kërku drejtësi?

Ia kishin qitë pritën në disa vende te Zejnullaht dhe në fshatin Qubrel, këtë ia tregoi një *korir* rom, që kishte punuar në Lludoviq.

Ai e kishte marrë kalin dhe ishte nisur nga një anë tjetër, nëpërmes fshatit Kllodernicë. Kishte shkuar në Beograd. I kishte marrë dokumentet gjashtë ditë para se të vendosej se ku do t'i vendosnin serbët.

Ai vazhdonte duke thënë se "Plagët tona janë të vjetra. Nuk kanë nisë me ne."

Na tregonte për gjyshin e tij, Halil Haxhinë. Ai në të vërtetë e kishte pasur mbiemrin Miftari, por pasi kishte shkuar në Haxh, të gjithë e thërrisnin Halil Haxhia dhe prej emrit të tij mbeti mbiemri i familjes sonë, Halili. Baci thoshte se Halili kishte qenë një nga dymbëdhjetë burrat që ishin nisur për në Vlorë më 16 nëntor 1912, për ta ngritur Flamurin. Por nuk arriti dot. Serbët e kishin zënë në Vushtrri dhe i kishin thënë:

-A je ti që ke thanë, "Ruajeni lapsin, se shpëtimi do të vijë prej tij"?

Duke e ditur se Halili njihej si njeri që ka ngritur shkollën shqipe në fshatin Vitak të Skenderajt, dhe i cili sillte libra nga Shqipëria që fëmijët e asaj ane të dinin shkrim e lexim, që të mos mbeteshin mbrapa vendeve përreth. Të gjithë i kishin pushkatuar me nga një plumb në qafë. Por Halilin e kishin shty të gjallë në një gropë të thellë dhe e kishin mbuluar me dhe.

Sa më shumë tregonte baci Jakup, aq më shumë kuptoja se ne nuk ishim duke jetuar një vuajtje të vetme e të re. Ishim pjesë e një zinxhiri që përsëritej prej brezash, me të njëjtin armik, me të njëjtën padrejtësi që ndryshonte vetëm emrin dhe uniformën.

Por ai shpesh përsëriste me respekt:

-Halil Haxhia, s'ka qenë vetëm gjyshi im. Ka qenë shembulli ynë.

E teksa tregonte historinë e tij, si ishte nisur për në Vlorë dhe nuk ishte kthyer më, donte të na motivonte.

Ai përmendte lapsin, fjalën, dijen, jo vetëm si kujtim nga katragjyshi, por si një thirrje për ne: që edhe aty në kamp, edhe pa libra, edhe pa tabela, të mos ndaleshim. Tani, kishim një arsye më shumë të vazhdonim mësimin.

Nëpër fusha, nën hijet e pemëve, improvizonin klasat tona. Secili grup zgjidhte një cep dhe mbanim distancën, për të mos e penguar tjetrin.

Kishim vetëm një qëllim: të vazhdonim aty ku na kishin ndalur, jo me pushkë, por me laps!

Dhe ndoshta, pa e kuptuar plotësisht, rrëfimi i tij për Halil Haxhinë na jepte një shtysë të heshtur, që të mos dorëzoheshim.

Sepse baci Jakup nuk na tregonte vetëm histori. Ai kishte zgjedhur të ishte aty i pranishëm, i përkushtuar. Kishte raste në mëngjes kur na merrte edhe me vete në Librazhd për Pazar, kurse ne e ndihmonim duke ia mbajtur qeset me perime. Pasdite na dërgonte të lumi për t'u larë, aty në Togëz.

Dëbimi për Maqedoni

Nga lufta, nuk ishim larguar në një drejtim të vetëm, neve na dëbuan drejt Shqipërisë, të tjerë i dëbuan për Maqedoni, në Mal të Zi, e prej andej shumë familje u shpërndanë në shtete të ndryshme të botës. Disa mbetën brenda Kosovës, duke ndërruar shtëpi, duke u fshehur në male, të tjerë në qytete. Disa prej tyre ranë në duart e forcave serbe, ku u keqtrajtuan, u dhunuan, u vranë.

Të dhënat e asaj kohe, flasin për afro tetëqind mijë shqiptarë të Kosovës që u detyruan të largoheshin nga shtëpitë e tyre.

Gjatë një bisede të zakonshme me Arbnora Ahmetin, në punë, e përmenda që isha duke shkruar për luftën, për jetën në kamp, për atë që na kishte ndodhur. Ndërkaq, ajo më tha se atë dhe familjen e saj i kishin dëbuar për Maqedoni. Ishte vetëm dymbëdhjetë vjeçe, kur në vitin 1999, bashkë me familjen u larguan nga shtëpia, prej Bregut të Diellit në Prishtinë.

Fillimisht shkuan te dajët në lagjen Tophanë, duke shpresuar se fqinjët serbë ose gruaja ruse e dajës do t'i mbronin. Të nesërmen, shumica vendosën të niseshin drejt Bllacës. Familja e Norës hipi në tren, i mbushur plot me njerëz që largoheshin si ajo. Policia

i kontrollonte e grabiste. Edhe ajo kishte fshehur stolitë e nënës nën rroba.

Në Bllacë, i priti balta, shiu dhe uria. Qëndruan disa ditë jashtë, më 2, 3, 4 prill '99, që do të thotë, tri ditë nën qiellin e hapur, pa kushte, nën dhunën e forcave maqedonase.

Pastaj, me autobus të organizuar nga shqiptarë të Maqedonisë së Veriut, u dërguan në Gostivar, më pas në Tetovë, ku fillimisht qëndruan në një kamp ushtarak gjerman. Më vonë, një mik i familjes, i strehoi në një shtëpi dhe Nora vazhdoi të shkonte në shkollë, ku mësonte edhe shqip.

Fundi i qershorit dhe fillimi i korrikut ishte koha kur të gjithë ata që kishin qenë të larguar, po ktheheshin në Kosovë.

Nora ishte kthyer më dy korrik. Unë isha kthyer pak më herët, më njëzet e katër qershor.

U kthyem nga drejtime të ndryshme, nga përvoja të ndryshme, por me të njëjtën ndjenjë: po ktheheshim në një vend që nuk ishte si më parë, ishte krejt ndryshe.

Isha vetëm dhjetë vjeç, por e mbaj mend mirë, ishim të parët nga kampi që po ktheheshim, dhe aty u siguruam se Kosova ishte çliruar. Ata që na përcollën nga kampi na përqafuan me lot e buzëqeshje. Kisha bërë një shok, Arianit Bogiqin, me të cilin isha shoqëruar shumë.

Lufta i kishte afruar njerëzit më shumë, i kishte bërë më të hapur me njëri-tjetrin. Kishim gjithmonë çfarë t'i pyesnim: "Prej nga je?", "Si e përjetuat ju?".

Dhe kur tjetri tregonte një histori të rëndë, ajo krijonte një lidhje të menjëhershme, sepse secili kishte kaluar diçka të ngjashme, ndjenim dhimbjen e tjetrit si vetes. Ndarja me njerëzit në kamp nuk qe e lehtë.

Kthimi në Kosovë

Kishte ardhur axha të na merrte. Ishte i veshur me uniformë të ushtrisë, me mjekër të lëshuar dhe disa kilogramë më pak. Një turmë njerëzish i shkonte pas, disa e falënderonin, disa e përqafonin, të tjerë e pyesnin:

-Qysh ia ke dalë gjatë këtyre muajve?

-A e kanë vra dikë nga ju?

-Qysh është gjendja?

-Çka ka mbet?

Ai mundohej t'u përgjigjej secilit me kujdes, duke treguar aq sa dinte. Të gjithë ishin të etur për lajme, për atë vend që e kishim lënë pas shpinës. U nisëm me një kamion të ngarkuar plot tri familje bashkë, me plaçka dhe tesha të shumta. Rruga ishte e gjatë, por dukej më e shkurtër nga rrëfimet e axhës. Ai fliste me një zë të qetë, duke na rrëfyer ato që kishte përjetuar.

Axha ishte kyçur në UÇK më 5 mars 1998. Shumicën e netëve i kishte kaluar në male, bashkë me babin tim, Sadikun. Në fillim ishin pak ushtarë, por më vonë numri u rrit, u bënë mbi tridhjetë e pesë veta, nën komandën e Rushit Halitit. Rrëfente për një aksion, ndër të tjera, kundër forcave serbe të pozicionuara në *rova* vetëm dy-tri kilometra larg shtabit, në lagjen Spahiu:

-Kur e gjuajtëm tankun me murtajë nga *rovat,* - tha, - tanku u kthye mbrapsht. - Pastaj shtoi, - Ka pas raste, kur kemi qenë aq afër me serbët, sa kemi përdorur edhe bomba dore.

Por nuk ishte vetëm rrëfim. Herë pas here e zinte gjumi aty në kamion, i lodhur nga gjithë ato kujtime. Por gjumi nuk i sillte qetësi, zgjohej si në ankth, duke pështpëritur emrin e doktor Zaim Bajramit. E kishte parë të vrarë në Izbicë, me një goditje në kokë. Ishte shok për të, sepse doktori nuk ishte vetëm mjek i mirë, por edhe ushtar, njeri i dashur, i afërt, shembull për të gjithë. Axhës i dukej sikur fytyra e tij e përgjakur nuk po i largohej më nga sytë.

Kthesat e rrugës na tundnin vazhdimisht. Sa herë kamioni dridhej, edhe axha zgjohej mes kujtimeve të tij. Por kur kamioni u afrua në kufi, në Kosovë, nuk u zgjua vetëm ai, u zgjuam të gjithë. Dhe kësaj here nuk po dëgjonim më rrëfimet e tij. Heshtja na kishte kapluar. Të gjithë shikonim jashtë, me të njëjtën kureshtje: si do të dukej Kosova që kishim lënë pas?!

Kosova nuk ishte më ajo që kishim lënë. Ishte djegur, shkatërruar. Por kur zbritëm në tokën tonë, ndjenjat ishin të përziera: ishim përmalluar për vendet, për njerëzit, për gjithçka që kishte mbetur mbrapa. KFOR-i ishte kudo. Na jepnin siguri. I përshëndesnim dhe na përshëndesnin. Për herë të parë pas kaq kohe, ndiheshim të lirë.

Përjetimi i luftës nga ata që qëndruan në Kosovë

Disa ditë më vonë takova dajën Alban. Ai kishte qëndruar në Kosovë gjatë gjithë luftës. Kishte përjetuar tërë atë që ne e kishim marrë vesh vetëm përmes lajmeve, me thashetheme, në copëza informacionesh që vinin.

Hera e fundit që ishim takuar, ishte fundi i korrikut të vitit 1998, kur unë shkova gjatë pushimeve verore te dajët në lagjen Zabeli ne Rezallë, ndërsa ai ato ditë shkoi te dajët e tij në fshatin Verbovc, në Komunën e Drenasit, pasi i kishte vdekur gjyshja. Unë qëndrova edhe disa ditë aty. Ishte ajo kohë kur aty e sollën një trup të pajetë... Nga kërshëria, hyra fshehurazi. Më vonë mësova se ishte Alush Berisha, babai i Fatonit dhe Valzonit, dy tezakëve të mi, me të cilët kisha luajtur ato ditë sa mungonte Albani.

Albanin e kishte zënë ofensiva e parë në Verbovc, në shtator të vitit 1998. Nga të shtënat e mëdha, rreth orës njëmbëdhjetë të pasdites, ishin nisur drejt fshatit Qirez, ku ishin bashkuar më shumë banorë nga fshatra të tjerë të Drenicës. Ku të gjithë ishin tubuar në vendin e quajtur Fushë-Mollë, vend që ndodhej mes fshatrave Qirez, Likoshan dhe Verbovc.

Rreth orës tre pasdite, forcat serbe i kishin rrethuar. Afërsisht, dyqind burra i kishin ndarë nga gratë e fëmijët. Disa kishin arritur të shpëtonin, dhe mes tyre edhe daja Hajriz, babi i Albanit, i cili, me vajzën shtatëvjeçare mbi supe, kishte gjetur një mënyrë për t'u larguar nga aty. Ata që nuk shpëtuan, i mbajtën gjithë natën nën roje. Të nesërmen, ata nga Drenasi i dërguan në Burgun e Lipjanit, ndërsa ata nga Skenderaj në Mitrovicë.

Edhe daja i tij, Xhafer Gllareva, përfundoi në burg dhe prej Lipjanit e çuan në Dubravë, ku u vra në Masakrën e Majit, në vitin 1999.

Albani ishte kthyer në Rezallë në fund të shtatorit.

Në mars të vitit 1999, familja e tij u zhvendos nga fshati Rezallë në qytetin e Skenderajt. Autoblindat serbe, të vendosura në fabrikën e municionit, e bënin fshatin të pasigurt.

Qyteti dukej më i mbrojtur, prandaj shkuam te një i afërm. Aty serbët e morën gjyshin. E mbajtën dy javë në stacionin e policisë, e rrahën dhe e pyetën për emra të UÇK-së. Ai nuk kishte pranuar të përgjigjej.

Në fillim të prillit, avionët e NATO-s bombarduan fabrikën e municionit. Albani tregon se shpërthimi kishte lëkundur shtëpinë, edhe pse ndodheshin

dy kilometra larg, dhe një re e zezë tymi kishte mbuluar qiellin.

Nga marsi deri në maj, dyqanet kishin qenë të mbyllura. Serbët vinin shpesh, i rreshtonin jashtë, duke u thënë se do t'i pushkatonin, pastaj i plaçkitnin dhe largoheshin. Kështu kaluan dy muaj me frikë e me pasiguri.

Në fillim të qershorit, para se të përfundonte lufta, serbët kishin ardhur për të regjistruar të gjithë anëtarët e familjes me një karton të gjelbër. E kishte bërë një serb, Zorani. Zyrtarisht, thoshin se ishte për ndihma, por Albani ishte i bindur se qëllimi i vërtetë ishte të dinin saktësisht kush kishte mbetur në Kosovë, për t'i vrarë më pas.

Rrëfimi i Albanit është një dëshmi e gjallë e vuajtjes dhe guximit të atyre që përballuan luftën nga brenda.

Falë ndërhyrjes ndërkombëtare, lufta kishte mbaruar, por rreziku mbetej ende.

Përveç rrëfimeve që ndanim me njëri-tjetrin për vrasjet, shkatërrimet, përdhunimet dhe gjithë ato tmerre që kishin bërë serbët, ata kishin lënë pas edhe tokën e minuar. Si pasojë e saj, humbën jetën qindra vetë dhe u plagosën qindra të tjerë.

E mbaj mend kur u ktheva në shtëpi, në Kosterc, sokaku ishte mbuluar me bari. Ecja me kujdes, por

besoja se rrugicat e vjetra ishin përmalluar, se edhe po të kishte mina, toka ime do të më mbronte. Në shtëpi nuk kishte mbetur asgjë. Flinim secili nëpër qoshe, pa strehë, derisa pas dy muajsh erdhën ndihmat: një shator për të fjetur dhe pak material për kulmin.

Baci Jakup flinte në katin e dytë të shtëpisë së tij, i vetmi kat që i kishte shpëtuar. Baci Mehë, flinte në një stallë. Albani qëndroi mbi një vit në çerdhe në Skenderaj.

Mes gurëve të rënë dhe barit të njomë, po mësonim të ngriheshim ngadalë.

PJESA E DYTË

NGA PËRJETIMI IM
TEK E DREJTA E POPULLIT

Hyrje e pjesës së dytë

Pas dhjetë viteve, vendosa që të studioja drejtësinë. Fryma, në të cilën isha rritur, më çoi drejt kësaj rruge. Në studimet posdiplomike, takova mentorin tim, Fatmir Sejdiun, njeriun që do të më ndihmonte të kuptoja më qartë, se çfarë kishte ndodhur dhe pse kishte ndodhur. Por kësaj radhe, përveç rrëfimeve të tij personale, që i kishte përjetuar vetë si pjesë e atyre ngjarjeve, ai do të më mësonte t'i shihja ato edhe në rrafshin juridik e politik.

Në këtë mënyrë, ndërtuam së bashku të vërtetën dhe drejtësinë. Për ta kuptuar më mirë rrugën e popullit tim deri këtu, nisa të kthehem pas, që do të thotë, përpara viteve të luftës. Më lindnin shumë pyetje: "Pse e kishin larguar gjyshin nga puna? Pse e kishin vrarë mësuesin tim që më mësoi shkronjat e para? A ishte organizimi i institucioneve të Kosovës një e drejtë për vetëvendosje, apo një guxim i rrezikshëm?"

Ishte viti '92 kur, mes shtypjes dhe frikës, Kosova mbajti zgjedhjet e saj parlamentare e presidenciale. Mbi këtë ngjarje vendosa ta përqendroja edhe temën time të diplomës, të cilën vendosa ta shfaq këtu me lexuesit. Dua të shkëpus disa njohuri në pika të shkurtra, që të kuptojmë më mirë rrjedhën e ngjarjeve. Sepse për ta rrëfyer, nuk mjaftonin vetëm doku-

mentet e ftohta dhe analizat, duheshin edhe zërat e atyre që e kishin jetuar, që përveç dijes, mbanin brenda edhe përvojën e asaj kohe.

Qëllimi im nuk është të riprodhoj tërësisht punimin akademik, por të sjell risi në një formë më të thjeshtuar disa nga idetë, analizat dhe përfundimet që mendoj se mbeten me vlerë edhe sot. Për ata që dëshirojnë të shohin analizën e plotë, tema ime origjinale mund të gjendet në Arkivin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare në Prishtinë.

Kur u takova me profesor Fatmirin, më dukej sikur po vazhdoja aty ku e kisha lënë me mësuesin Haxhi. Sidomos kur tha:

-Je studenti im i fundit, sepse pas teje do të dal në pension.

Kur i tregova për librin, ai buzëqeshi lehtë, një buzëqeshje që fshihte kujtime të rënda.

-Ajo që ndodhi në atë kohë, - më tha, - nuk mund të kuptohet pa ndjerë peshën e asaj kohe.

Atëherë vendosa që, krahas dokumenteve dhe ligjeve, të marr edhe referimet dhe mendimet e tij. Sepse bisedat me të nuk ishin vetëm mësim. Ishin kujtime, ishin vështrime, ishin pyetje që më shtynin të mendoja ndryshe. Kështu, fillova ta ndërlidh të kaluarën time me të kaluarën e Kosovës, jo vetëm si kujtim, por edhe si çështje juridike e politike.

KAPITULLI I

Tensionet politike dhe shpërbërja e Jugosllavisë...

Në fund të viteve '80 dhe fillim të viteve '90, Kosova dukej sikur po jetonte në prag të shpërthimit. Jugosllavia po shpërbehej ngadalë, ndërsa ambicia e Serbisë për dominim po rritej çdo ditë. Në Kroaci e Bosnjë kishte shpërthyer lufta, ndërsa në Slloveni pjesërisht. Në Kosovë, frika ishte e përditshme, por edhe vendosmëria ishte rritur, se nuk kishte më kthim prapa. Kosova, me shumicë etnike shqiptare dhe pozicion të rëndësishëm gjeopolitik, paraqitej si rast i veçantë brenda federatës, por pa status republike.

Shqiptarët argumentonin të drejtën e tyre historike, natyrore e njerëzore për barazi, duke u mbështetur edhe në dokumente ndërkombëtare, sidomos në Kartën e Kombeve të Bashkuara, që garantonte parimin e vetëvendosjes.[1]

Pikërisht mbi këto parime u mbështetën edhe demonstratat studentore të vitit 1968, që shënuan kthesën e parë të madhe me kërkesën për status Republikë të Kosovës.

Këto demonstrata shpërthyen në Prishtinë, Gjilan, Ferizaj, Podujevë dhe u përhapën edhe në

[1] Mr. Fatmir Sejdiu, "Çështja e Kosovës – Një problem historik dhe aktual", Simpoziumi i mbajtur në Tiranë më 15-16 Prill 1993, Tiranë 1996, f.371

Maqedoni. Edhe pse paqësore, pati të plagosur dhe të vrarë. Këto protesta sollën disa ndryshime kushtetuese në favor të Kosovës, e më vonë edhe nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1974, e cila i dha Kosovës status të barabartë me republikat tjera jugosllave në shumë aspekte. Ajo kishte përfaqësues të drejtpërdrejtë në forumet kryesore të Federatës Jugosllave[2].

Ky zhvillim përbente një hap të rëndësishëm drejt afirmimit të subjektivitetit politik të Kosovës brenda federatës, megjithëse ende i pakënaqshëm dhe i kufizuar në praktikë.

Kjo pakënaqësi do të rikthehej me demonstratat masive të vitit 1981, kryesisht nga studentët. Ato u pasuan nga represioni serb, por treguan se pakënaqësia e shqiptarëve ishte bërë e gjerë në popullsi. Këto ngjarje u konsideruan vazhdimësi e kërkesave të vitit 1968.[3]

Këto zhvillime dëshmojnë për një kontinuitet të kërkesave politike të shqiptareve, të cilat me kalimin e viteve morën karakter gjithnjë e më të artikuluar dhe përfshinë shtresa të gjera të shoqërisë.

Në mesin e viteve '80, Serbia organizoi mekanizma politikë dhe propagandistikë kundër shqiptarëve.

[2] Noel Malcolm, "Kosova: Një histori e shkurtër", botimi i katërt, Prishtinë, korrik 2019, f.379

[3] Dr. Ana Lalaj "Çështja e Kosovës – Një problem historik dhe aktual", Simpoziumi i mbajtur në Tiranë më 15-16 Prill 1993, Tiranë 1996, f.277-278

Shfaqja e "Memorandumit" të Akademikëve serbë në dhjetor të vitit 1986 dhe hapjen e çështjeve në të, siç ishin ato, me anën e të cilave Jugosllavia e Titos shpallej: "krijesë e popullit serb" e krijuar sipas "një kurthi të Kominternit kundër popullit serb", që "t'i humbiste në paqe ato që i kishte fituar në luftë dhe, ndër "të humburat ishte edhe Kosova, që sipas autorëve të Memorandumit, paraqet shpirtin serb nga mesjeta e tutje".[4]

Në thelb, "Memorandumi" përbënte jo vetëm një dokument akademik, por një platformë politike që legjitimoi pretendimet territoriale të Serbisë dhe përgatiti terrenin për konfliktet e përgjakshme që pasuan në hapësirën jugosllave.

Për intelektualët shqiptarë, shfaqja e "Memorandumit" të akademikëve serbë si dhe solidarizimi i plotë me të i Kishës Ortodokse Serbe, i shkrimtarëve si dhe i pjesës më të madhe të intelektualëve serbë, ishte ogur ndaj të cilit duhej reaguar menjëherë në planin intelektual, por edhe në atë politik, pa përjashtuar mundësinë, që në rrethanat e caktuara, të merret edhe përgjegjësia politike.[5]

Reagimet e intelektualëve shqiptarë shënuan një kthesë të rëndësishme, pasi e zhvendosën debatin për

[4] Jusuf Buxhovi, "Kosova 1945-1999", Shtëpia botuese Faik Konica, Prishtinë 2019, f. 206-208

[5] Po aty

Kosovën, nga kuadri i brendshëm federativ në një çështje me dimension ndërkombëtar.

Për të kërkuar barazi të plotë me të tjerët si pjesë e barabartë e federalizmit, në fillim reagimet ndaj "Memorandumit" serb ishin individuale. Të shumta, ishin vështrimet dhe kritikat, të botuara në shtypin e Zagrebit dhe të Lubjanës, ku intelektualët shqiptarë kishin hapësirë shprehjeje, ku prej andej zëri i tyre përhapej në vend, por edhe në botë. Ndërsa më vonë, ato do të ktheheshin në një kundërvënie të përbashkët, që Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës filloi ta kthente në një adresë ku, për herë të parë, zunë të shpaloseshin interesat politikë dhe shoqërorë të shqiptarëve[6]

Këto zhvillime, dëshmuan se çështja e Kosovës po dilte përfundimisht nga kuadri i heshtjes politike, duke hyrë në fazën e vetë organizimit kombëtar që do të përcaktonte rrjedhën e dekadës në vijim.

[6] Po aty

Shembja e pozitës kushtetuese të Kosovës nga Serbia

Pas përhapjes së ideologjisë nacionaliste serbe ne mesin e viteve '80 dhe pas miratimit të "Memorandumit" të Akademisë Serbe të Shkencave, marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë hynë në një fazë të re tensioni politik e institucional. Në këtë kontekst, ofensiva serbe filloi intelektualisht.

Pas "Memorandumit" të Akademisë Serbe të Shkencave (1986), shkrimtarët serbë kërkuan ndryshime kushtetuese për të rikthyer gjendjen para vitit 1974.[7]

Këto ide e nxiten një reagim të gjerë në qarqet intelektuale shqiptare, të cilat e panë qartë se Serbia po përgatitej për ta cenuar pozitën kushtetuese të Kosovës.

Në debatet e vitit 1988, shkrimtarët shqiptarë, me Ibrahim Rugovën, kundërshtuan hapur, duke mbajtur të drejtën për vetëvendosje.

Këto debate tërhoqën vëmendjen e mediave perëndimore, gjë që ekspozoi propagandën serbe dhe forcoi qëndrimin shqiptar në opinionin ndërkombëtar.

Ndërkohë që debati publik vazhdonte të thellohej, Beogradi filloi te ndërhynte drejtpërdrejt në strukturat politike të Kosovës.

[7] Buxhovi, f.210-214

Në vjeshtë të vitit 1988, Beogradi largoi Azem Vllasin dhe Kaqusha Jasharin nga udhëheqja e Kosovës dhe vendosi figura të dëgjueshme ndaj Serbisë[8], siç ishte Rrahman Morina.

Këto veprime nxitën pakënaqësi të madhe në mesin e qytetareve dhe sollën një valë të re protestash e grevash në gjithë Kosovën.

Në nëntor 1988, punëtorët e "Staritërgut" marshuan drejt Prishtinës, duke u bashkuar me studentë dhe punëtorë të tjerë, ku brenda disa ditësh u mblodhën afër një milion protestues.

Këto protesta shënuan një pikë kthese në rezistencën qytetare kundër politikës serbe. Ato krijuan një frymë solidariteti të gjerë që vazhdoi edhe në muajt në vijim, duke u përqendruar në minatorët e Trepçës, të cilët morën përsipër ta qonin përpara këtë qëndresë. Në shkurt 1989, minatorët e Trepçës hynë në një grevë urie tetë ditore nën tokë, duke kërkuar ruajtjen e Kushtetutës së vitit 1974 dhe dorëheqjen e Rrahman Morinës.[9]

Greva e minatorëve tronditi pushtetin serb dhe zgjoi ndjenjën e solidaritetit në të gjithë Kosovën, përballë këtij uniteti, Beogradi reagoi me dhunë dhe masa te ashpra shtypëse, me arrestime, gjyqe të

[8] Malcolm, f.395

[9] Prof. Mujë Berisha, "Parlamenti dhe Demokracia në Kosovë", Shtëpia botuese siprint -Prizren 1998 f.58

montuara dhe spastrim të kuadrove politike, kulturore, arsimore e ekonomike shqiptare.

Pas këtyre ngjarjeve, Beogradi ndërmori hapin vendimtar për të shuar autonominë e Kosovës dhe për të vendosur kontroll të plotë politik e ushtarak.

Më 23 mars 1989, me presion ushtarak dhe tanke jashtë sallës së Kuvendit të Kosovës, delegatët u detyruan të miratonin amendamente që shuanin autonominë. Vetëm dymbëdhjetë delegatë votuan kundër. Kjo kushtetutë ishte e njohur me emrin "Kushtetuta e tankeve", të cilën populli i Kosovës nuk e njohu kurrë[10]; në ditën e votimit protestuan mijëra veta në qendër të Prishtinës duke gjuajtur me gurë. Brenda pak ditësh protesta u zgjerua në gjithë Kosovën. Numri zyrtar i të vrarëve në fund të marsit numëronte 21 demonstrues dhe 2 policë; nga fundi i prillit numri (i protestuesve të vrarë) arriti në 100[11].

Kjo do të shënonte fillimin e një fushate të gjerë hakmarrëse ndaj gjithë atyre që kishin kundërshtuar ndryshimet kushtetuese. Ku mijëra punëtorë, intelektualë, gazetarë, profesorë e politikanë u arrestuan dhe u mbajtën të mbyllur në burgje pa të drejtë mbrojtjeje.

Në javët që pasuan, situata në Kosovë ndryshoi rrënjësisht. Beogradi vendosi masa të jashtëzakonshme

[10] Buxhovi 2019, f.217.
[11] Malcolm 2019, f.397

dhe filloi zbatimin e një administrate të drejtpërdrejtë serbe.

Serbia mori në kontroll të gjitha mekanizmat institucionale dhe shoqërore në Kosovë. Komisarët serbë të sjellë nga Beogradi vepronin arbitrarisht, duke shkarkuar e emëruar në mënyrë të dhunshme.[12]

Me konsolidimin e kontrollit të plotë mbi institucionet e Kosovës, Beogradi vazhdoi procesin formal të suprimimit të autonomisë. Ky hap u kurorëzua pak javë më vonë me ndryshimet ligjore që e bënë këtë politikë fakt të kryer.

Më 28 mars 1989, Kuvendi i Serbisë miratoi zyrtarisht amendamente që shuanin autonominë e Kosovës. Në saje të forcave të nacionalizmit serb, të cilët i kishte përgatitur aq me mjeshtëri, Slobodan Millosheviqi, tashti dukej si një forcë që s'kishte të ndalur.[13]

Pas kësaj fitoreje politike, Millosheviqi kërkoi ta shfrytëzonte momentin për të forcuar më tej ndikimin e tij. Ai e ktheu mitingun e Gazimestanit në një skenë të propagandës nacionaliste dhe të mobilizimit serb.

Më 28 qershor 1989, rreth 1 milion serbë u sollën nga e gjithë Jugosllavia në Gazimestan, në Kosovë.

[12] Buxhovi vep e cit, f. 217-218
[13] Malcolm 2019, f.397

Millosheviqi premtoi se "Serbia do t'i arrijë qëllimet më të mirë ose me dhunë". Ky ishte një tubim masiv përkujtimor me rastin e 600 vjetorit të Betejës së Kosovës (1389). Në fjalimin e tij, Millosheviqi përdori tone nacionaliste dhe paralajmëroi se serbët përsëri mund të hynin në beteja. Ky miting u bë simbol i pushtimit serb dhe fillimit të agresioneve të ardhshme në Slloveni, Kroaci e Bosnjë.

Fjalimi i Millosheviqit dhe politika e dhunshme që pasoi në Kosovë ndezën pakënaqësi të madhe tek shqiptarët. Pas mitingut në Gazimestan, reagimet u shtuan edhe më shumë dhe Kosova hyri në një periudhë të vazhdueshme protestash.

Protestat vazhduan pothuajse çdo muaj me pjesëmarrje të studentëve, dhe sidomos të minatorëve të Trepçës.

Kjo do të pasoj masa ndëshkuese kundër studentëve dhe minatorëve që kishin marrë pjesë në greva e demonstrata.

Më 8 gusht 1989, 2715 minatorë u pushuan me dhunë nga puna[14]. Qindra u dënuan me vite burg me akuza të rreme për "revolucion".

Megjithatë, protestat nuk u ndalën dhe ato lanë gjurmë të thella te studentët e asaj kohe. Njëri prej tyre

[14] Berisha 1998, f.55-56

ishte Xhemail Halili, atëbotë student i vitit të pestë i Fakultetit Teknik në drejtimin e Makinerisë, i cili në një bisedë me të i kujton ato ditë protestash në Prishtinë:

"Në tetor 1989, demonstratat studentore në Prishtinë ishin të përditshme dhe masive. Në Qendrën e Studentëve dhe rreth Konvikteve ndihej zemërimi ndaj pushtuesit serb. Si bashkëpunëtor në redaksinë e Botës së Re, sapo dorëzova një shkrim, dhe menjëherë iu bashkova protestuesve. Gjatë shpërndarjes së protestës, një spiun i pushtetit më dredhoi krahun dhe pas kacafytjes me të, ndërhynë policët serbë të cilët më arrestuan. Kur më dërguan në stacionin policor më rrahën e më pas më dënuan me gjashtëdhjetë ditë burg, të cilat i vuajta në Dubravë, në nëntor dhe dhjetor 1989".

Dëshmia e Xhemailit pasqyron qartë atmosferën e tensionuar të atyre ditëve dhe mënyrës se si dhuna e pushtetit serb prekte çdo student e qytetar që ngrinte zërin për liri. Përvoja e tij nuk ishte e vetme, ajo përfaqëson qindra raste të ngjashme të rinjsh që u përballën me arrestime, rrahje e dënime të padrejta. Përmes këtyre ngjarjeve, shihet qartë se Serbia po vendoste pushtetin e saj të paligjshëm në Kosovë përmes dhunës dhe represionit.

Shqiptarët, megjithëse të shtypur, ruajtën përcaktimin e tyre për barazi, vetëvendosje dhe demokraci.

Përkundër shtypjes dhe represionit të vazhdueshëm, shqiptarët filluan të organizoheshin politikisht dhe të artikulonin më qartë qëndrimin e tyre ndaj pushtimit serb.

Pas abrogimit të autonomisë së Kosovës nga Serbia dhe fjalimit kërcënues të Millosheviqit në Gazimestan, Ibrahim Rugova paralajmëroi, përmes gazetës gjermane Der Spiegel, se Kosova ishte "ripushtuar nga Serbia".[15]

Deklaratat e Rugovës dhe përpjekjet e tij për të sensibilizuar opinionin ndërkombëtar e bënë atë figurë të njohur në rrafshin diplomatik.

Për ta mbrojtur atë nga burgosja, Departamenti i Shtetit dhe ambasadori amerikan Zimmerman, shfaqën mbështetje publike për Rugovën.[16]

Kjo mbështetje ndërkombëtare i hapi rrugë organizimit të qëndresës politike në Kosovë.

[15] Shih intervistën e dr.Ibrahim Rugovës në "Der Spiegel", 26 korrik 1989.
[16] Buxhovi 2019 f. 220

Themelimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, dhjetor 1989

Në rrethana të rënda politike dhe pas një fushate të ashpër shtypjeje ndaj shqiptarëve, në fund të vitit 1989 u shfaqën përpjekjet e para për organizimin politik. Këto nisma synonin të kanalizonin rezistencën paqësore dhe të krijonin përfaqësim të unifikuar të popullit te Kosovës.

Me mbështetje të SHBA-së, më 23 dhjetor '89 u mbajt Kuvendi themelues në Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës, ku morën pjesë 127 veta[17]. Ibrahim Rugova u zgjodh kryetar i LDK-së. Brenda një kohe të shkurtër LDK-ja u shndërrua ne lëvizje gjithëpopullore, duke përfshi intelektualë, punëtorë, studentë dhe qytetarë nga të gjitha viset e Kosovës. Fryma e saj paqësore dhe orientimi demokratik, i dhanë besueshmëri të gjerë në opinionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar. LDK-ja mblodhi rreth 200 000 anëtarë, duke rrënuar praktikisht Lidhjen Komuniste të Kosovës[18]. Deri në mars 1990 kishte gjysmë milioni. LDK deklaroi se ishte përfaqësuesja e vetme legjitime e shqiptarëve të Kosovës, e cila merrte përgjegjësinë për fatin e vendit.

---

[17] Po aty f. 223.

[18] Adem Beha: "Mes Stabilitetit & Demokratizimit" 17, f.93

Krijimi dhe zgjerimi i shpejtë i LDK-se shënuan një kthesë të madhe në zhvillimet politike të Kosovës. Ajo u shndërrua në lëvizje aq të madhe që bashkoi shqiptarët rreth idesë së rezistencës paqësore dhe kërkesës për pavarësi.

Themelimi i LDK-së shënoi fillimin e shkëputjes legale e paqësore të Kosovës nga Serbia. Beogradi reagoi ashpër, duke kërkuar arrestimin e Rugovës, por nuk arriti ta ndalte përhapjen masive të partisë. U formuan edhe partitë e tjera shqiptare (Partia Fshatare, Partia Socialdemokrate, Partia Parlamentare dhe Partia Kristiandemokratike).[19] Në prill 1990, Rugova deshmoi në Kongresin Amerikan për të drejtat e shqiptarëve dhe për planet e shpalljes së pavarësisë.

SHBA i dha mbështetje, me kusht që Kosova të ndiqte rrugën e rezistencës civile dhe demokratike, duke shmangur luftën.

Ndërsa shqiptarët po e konsolidonin rrugën e rezistencës paqësore, Beogradi nisi një fushatë të re provokimesh me qëllim që të nxiste reagime të dhunshme dhe të justifikonte ndërhyrjen ushtarake.

Një nga ngjarjet më të renda ishte helmimi masiv i mijëra nxënësve shqiptarë në shkolla (1990), që sipas analizave të BE-së përfshinte përdorimin e gazit

[19] Dr. Elez Biberaj, "Çështja e Kosovës – një problem historik dhe aktual", Simpoziumi i mbajtur në Tiranë më 15 – 16 Prill 1993, Tiranë 1996, f.302.

helmues "sarin" ose "tabun". Më vonë, u vërtetua se armata jugosllave e kishte prodhuar këtë helm.[20]

Përballë kësaj, shqiptarët zgjodhën rrugën e organizimit politik dhe rezistencës paqësore.

[20] Malcolm f.398.

KAPITULLI II

Kuvendi i Kosovës nga Rezistenca Politike deri në shpalljen e Pavarësisë se Kosovës - 02.07.1990

Përfundimi i viteve '80 solli një realitet të ri politik në Kosovë. Pushtimi administrativ dhe represioni i vazhdueshëm serb e shndërruan çështjen e Kosovës prej në problemi të brendshëm jugosllav në një çështje kombëtare e politike që kërkonte zgjidhje.

Pas puçit kushtetues të Serbisë ndaj Kosovës në vitin 1989 dhe veprimeve diskriminuese që pasuan, shqiptarët filluan të organizohen për shpalljen e Republikës së Kosovës. Serbia, përmes ligjeve dhe programeve të saj, synonte kolonizimin e Kosovës me serbë dhe dobësimin e pozitës së shqiptarëve. Kjo përfshinte ndalimin e shitblerjes së pronave, mbylljen e institucioneve arsimore e kulturore shqiptare, si dhe largimin e mijëra shqiptarëve nga puna[21].

Përballë diskriminimit sistematik dhe mbylljes së çdo hapësire për veprim institucional, përfaqësuesit shqiptarë e panë shpalljen e Republikës si hapin e vetëm për të mbrojtur identitetin dhe të drejtat e tyre.

Në këtë situatë, më 2 korrik 1990, Kuvendi i Kosovës me shumicë shqiptare shpalli Deklaratën Kushtetuese, duke shpallur Kosovën si njësi të

[21] Po aty f.399

pavarur dhe të barabartë brenda Federatës Jugosllave. Me këtë akt u zhvlerësuan edhe vendimet serbe, përfshirë Rezolutën e Prizrenit të vitit 1945 që kishte bashkuar Kosovën me Serbinë.

Ky veprim i guximshëm i deputetëve shqiptarë u konsiderua nga Beogradi si sfidë e hapur ndaj rendit Kushtetues serb dhe ndaj dominimit të tij në Kosovë.

Reagimi i Serbisë ishte i ashpër: me një ligj të ri për marrëdhëniet e punës, u pushuan nga puna mbi 80 mijë shqiptarë[22], ndërsa Kuvendi i Kosovës vazhdoi përgatitjen për shpalljen e pavarësisë dhe miratimin e kushtetutës së saj.

Pavarësisht represionit dhe përjashtimeve masive, ideja e shtetësisë së Kosovës tashmë ishte bërë realitet politik dhe moral, që nuk mund të ndalej më.

[22] Po aty

Miratimi i Kushtetutës së Kosovës më 7 shtator 1990 dhe rëndësia e saj juridike e politike

Pas shpalljes së Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut 1990, delegatët shqiptarë vazhduan punën për të mbyllur procesin e konstituimit të Republikës së Kosovës. Në rrethana të jashtëzakonshme politike dhe nën masa të rënda represive, delegatët shqiptarë punuan fshehtas për të hartuar një kushtetutë të plotë, e cila do të garantonte sovranitetin juridik e politik të vendit.

Më 7 shtator 1990, në qytetin e Kaçanikut, delegatët shqiptarë shpallën ligjin kushtetues për Republikën e Kosovës, duke e shpallur Kosovën Republikë me Kuvend dhe Kryesi të vet. Ky akt, u bë në kushte të fshehta, për shkak të presionit dhe dhunës serbe.

Detyrat kryesore që u përcaktuan ishin:

- Shpallja e referendumit për pavarësi;
- Mbajtja e zgjedhjeve të lira parlamentare;
- Formimi i qeverisë së Republikës së Kosovës[23].

Këto pika përbënin bazën ligjore dhe politike mbi të cilën do të ndërtohen institucionet e Republikës së Kosovës në vitet që pasuan.

[23] Po aty f. 237

Referendumi për pavarësi u konsiderua pika më e rëndësishme e këtij procesi. Ai përfaqësonte rrugën paqësore të shqiptarëve të Kosovës përballë dhunës serbe. Ky proces u mbështet edhe nga shqiptarët në Maqedoni, Preshevë, Mal të Zi dhe në hapësirat tjera të ish-Jugosllavisë, duke ndërtuar kështu edhe themelet e shtetit paralel të Kosovës.[24]

Miratimi i Kushtetutës së Kaçanikut i dha legjitimitet juridik Republikës së shpallur më 2 korrik dhe vulosi përfundimisht ndarjen politike të Kosovës nga Serbia.

[24] Po aty

Organizimi dhe mbajtja e Referendumit për Pavarësinë e Kosovës, 26-30 shtator 1991

Pas miratimit të Kushtetutës së Kaçanikut në shtator 1990, institucionet e Republikës së Kosovës filluan të veprojnë në mënyrë të organizuar, me qëllim që vendimet politike të mbështeteshin në vullnetin e popullit. Kështu, si hap i radhës, u bë organizimi i një referendumi gjithë popullor që do të vërtetonte legjitimitetin e pavarësisë së shpallur dhe do ta afirmonte Kosovën si subjekt politik të barabartë me republikat tjera të ish-Jugosllavisë.

Më 26-30 shtator 1991, në Kosovë u organizua referendumi për pavarësi, i cili u mbajt mbi bazën e Kushtetutës së Kaçanikut (1990). Pyetja drejtuar qytetarëve ishte nëse e pranonin Kosovën si shtet sovran dhe të pavarur me të drejtë pjesëmarrjeje në lidhjen e shteteve sovrane.

- Pjesëmarrës ishin 87% e votuesve.

- Rezultati rrjedhës është ky: 99% votuan në favor të pavarësisë.

Ky referendum, konfirmoi Deklaratën e Pavarësisë dhe Kushtetutën e Kosovës, të miratuar një vit më parë, duke shërbyer si bazë për organizimin e shtetit dhe mbrojtjen e kauzës për pavarësi.

Rezultatet e referendumit i dhanë Kosovës një bazë të fuqishme demokratike për përfaqësim ndërkombëtar, në një kohë kur federata jugosllave po shpërbëhej dhe situata politike në rajon po përkeqësohej me shpejtësi.

Megjithatë, përkundër vullnetit të qartë të popullit, realiteti politik në ish-Jugosllavi po ndryshonte me shpejtësi dhe krijonte sfida të reja për Kosovën.

Shqiptarët e kuptuan se me shpërbërjen e Jugosllavisë dhe shpërthimin e luftërave në rajon, edhe Kosova do të përfshihej në zhvillime të ngjashme, ndaj duhej të ishte e përgatitur për çdo situatë.

Më 11 tetor 1991, Këshilli Koordinues i partive politike shqiptare miratoi deklaratën politike, ku parashihej se:

1. Nëse nuk ndryshojnë kufijtë e jashtëm e as të brendshëm të Jugosllavisë, duhet të ekzistojë Republika e Kosovës si shtet i pavarur.

2. Nëse kufijtë e jashtëm të Jugosllavisë nuk ndryshojnë, por ndryshojnë kufijtë e brendshëm ndërmjet republikave, atëherë kërkesa është për Republika shqiptare në Jugosllavi.

3. Nëse ndryshojnë kufijtë e jashtëm në Jugosllavi, atëherë populli shqiptar do të kërkojë bashkimin e territoreve në të cilat jetojnë shqiptarët.[25]

[25] Sipas Fatmir Sejdiut. Pun. i cit. f.376

Kjo deklaratë e 11 tetorit 1991 përmbylli fazën e institucionalizimit të pavarësisë së Kosovës, duke e përcaktuar qartë qëndrimin politik të saj ndaj shpërbërjes së Jugosllavisë dhe duke afirmuar të drejtën e shqiptarëve për vetëvendosje në çdo rrethanë.

Rëndësia politike dhe pesha ndërkombëtare e referendumit si dhe përputhja kohore e tij me referendumet e ngjashme

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë, popujt që përbënin federatën kërkuan të drejtën për vetëvendosje dhe shpallën pavarësinë përmes referendumeve të mbajtura mes viteve 1990-2006 në të 6 republikat, si dhe në Kosovë. Vetëm njëri nga këto referendume për pavarësi arriti të shkëputej pa gjakderdhje - ai i Malit të Zi në vitin 2006.[26]

Në rastin e Kosovës, rruga drejt pavarësisë ishte më e vështirë dhe e ndërlikuar, pasi Serbia nuk e njihte as legjitimitetin e institucioneve të saj, as të drejtën për vetëvendosje, megjithatë, vendosmëria e popullit dhe mbështetja graduale ndërkombëtare e mbajtën të gjallë procesin politik drejt lirisë.

Krahasuar me republikat e tjera të Jugosllavisë, shqiptarët ishin të hendikepuar, sepse nuk kishin status të barabartë juridik si subjekt federativ. Kushtetuta e vitit 1974 e njihte Kosovën si element konstituiv, por jo si republikë të veçantë. Kjo krijoi gjendje duale dhe vështirësi në procesin e vetëvendosjes.[27]

---

[26] https://balkaninsight.com/2016/09/21/spektri-i-dhun%C3%ABs-q%C3%ABndron-mbi-referendumin-e-bosnj%C3%ABs-09-20-2016/?lang=sq

[27] Buxhovi f.280-287

Kjo qasje tregoi se çështja e Kosovës, për një kohë të gjatë, u perceptua në plan humanitar dhe jo si problem politik e shtetëror. Vetëm më vonë, me përshkallëzimin e krizave në Bosnjë dhe Kroaci, faktori ndërkombëtar filloi të kuptonte se pa zgjidhjen e statusit të Kosovës, paqja në rajon do të mbetej e brishtë.

Ndërkohë, interesimi ndërkombëtar për Kosovën u fokusua më shumë te shkeljet e të drejtave të njeriut sesa te çështja e statusit politik.

Në shkurt 1990, Jugosllavia u pranua me "statusin e mysafirit" në Asamblenë e Këshillit të Evropës - një privilegj diplomatik që shihej si hap i parë drejt anëtarësimit në strukturat evropiane. Megjithatë, ky status u kushtëzua nga Këshilli i Evropës me mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare të lira dhe demokratike në vjeshtën e vitit 1990. Legjitimiteti i tyre do të varej drejtpërdrejt nga pjesëmarrja e shqiptarëve, pa të cilët procesi zgjedhor nuk mund të konsiderohej i besueshëm.[28]

Megjithatë, Jugosllavia kërkonte të ruante legjitimitetin ndërkombëtar, brenda saj po rritej përçarja politike dhe mosnjohja e të drejtave të shqiptarëve të Kosovës, duke e bërë të pashmangshëm konfliktin e ardhshëm.

[28] Buxhovi f.280-287

Në këtë rrethanë, Kosova për herë të parë pa një mundësi për të ngritur zërin e saj në arenën ndërkombëtare. Shqiptarët bojkotuan zgjedhjet me arsyetimin se, pas Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut dhe vendimit të Kuvendit të Kaçanikut për shpalljen e Republikës së Kosovës, me Serbinë nuk i lidhte asgjë, përveç një mundësie të barabartë në federatë ose konfederatë.[29] Po ashtu theksuan se, Kosova do të mbante së shpejti zgjedhjet e veta parlamentare, në përputhje me Kushtetutën e Kaçanikut. Në të njëjtën kohë, u kundërshtua hapur trajtimi i privilegjuar i Serbisë, duke u nënvizuar se një shtet që ushtron dhunë dhe mohon të drejtat e shqiptarëve, nuk mund të shpërblehej me status politik në Evropë.

Gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë, në fillim të viteve '90 u mbajtën disa referendume për pavarësi në republikat e saj. Këto zhvillime në hapësirën Jugosllave ndikuan drejtpërdrejtë edhe në Kosovë, e cila, ndonëse pa status republike, e konsideronte veten pjesë të këtij procesi shpërbërjeje dhe vetëvendosje.

Kroacia e Sllovenia nisën procesin e shkëputjes përmes referendumit, që çoi në luftë të armatosur. Sllovenia arriti ta shpallte pavarësinë në qershor 1991, me më pak humbje, lufta zgjati vetëm dhjetë ditë.

[29] Po aty 290-291

Ndërsa Kroacia, u përfshi në një luftë të përgjakshme që zgjati plot katër vjet dhe mori më shumë se 20,000 jetë. Në Maqedoni, mbi 96% e votuesve mbështetën pavarësinë në shtator 1991, të cilët parashikuan mundësinë e pjesëmarrjes në një union të ish-shteteve të Jugosllavisë. Në Mal të Zi u mbajt referendumi në mars 1992 për të qëndruar pjesë e Jugosllavisë. Bosnja dhe Hercegovina gjithashtu shpalli pavarësinë pas referendumit të saj, duke hyrë në një konflikt të përgjakshëm.[30] me mbi 200 000 të vrarë.

Pas valës se referendumeve për pavarësi në republikat e tjera të ish-Jugosllavisë, edhe Kosova u përpoq të afirmonte veten si subjekt politik me vete, duke ndjekur të njëjtën rrugë legjitime të vetëvendosjes kombëtare. Siç e kemi cekur edhe më parë, mbajti referendumin e saj më 26-29 shtator 1991, ku 99% e shqiptarëve votuan për pavarësi dhe shpallën Kosovën si republikë sovrane. Megjithatë, ky referendum u injorua nga Beogradi dhe nuk u njoh nga bashkësia ndërkombëtare, përveç Shqipërisë. Shqiptarët, nën udhëheqjen e Ibrahim Rugovës, ndoqën një qasje paqësore, duke shmangur luftën e menjëhershme dhe duke kërkuar mbështetje ndërkombëtare.

Kjo strategji e rezistencës paqësore u bë themeli i politikës shtetformuese të Kosovës gjate viteve '90, duke

[30] https://balkaninsight.com/2016/09/21/spektri-i-dhun%C3%ABs-q%C3%ABndron-mbi-referendumin-e-bosnj%C3%ABs-09-20-2016/?lang=sq

synuar krijimin e institucioneve paralele dhe ruajtjen e unitetit kombëtar përmes mjeteve demokratike.

Rugova, kërkonte vendosjen e Kosovës nën Protektoratin e OKB-së, duke theksuar se, pa një zgjidhje të pranueshme për shqiptarët, nuk mund të sigurohej paqe afatgjate në rajon.

Megjithatë, Serbia vazhdoi represionin dhe dhunën ndaj shqiptarëve, duke e vënë Kosovën përballë krizave të vazhdueshme, si edhe Bosnjën e Hercegovinën e Kroacinë, ku u krye gjenocid dhe u shkelën të drejtat njerëzore.

Ky represion i vazhdueshëm dëshmoi se politika paqësore e Kosovës po përballej me një regjim që synonte kontroll total përmes frikës dhe dhunës sistematike.

Bashkësia ndërkombëtare reagoi me sanksione politike e ekonomike kundër Serbisë dhe Malit të Zi. Në këto rrethana, Komisioni i Badinterit shpalli se Jugosllavia nuk ekzistonte më si subjekt ndërkombëtar, dhe se republikat e ish-Jugosllavisë duhej të kërkonin njohje të reja ndërkombëtare.

Në këtë mënyrë, Kosova mbeti jashtë procesit të njohjeve ndërkombëtare, ndonëse kishte përmbushur të gjitha kriteret e një shteti de facto, duke treguar se çështja e saj po hynte në një fazë të re të kërkimit të legjitimitetit ndërkombëtar.

KAPITULLI III

Organizimi i zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale në Kosovë më 24 maj 1992; pesha dhe rëndësia e tyre juridike-politike dhe historike

Pas referendumit për pavarësi të vitit 1991 dhe shpalljes së Kushtetutës së Kaçanikut, hapi i radhës në konsolidimin e shtetësisë së Kosovës ishte organizimi i zgjedhjeve të lira dhe demokratike, të cilat synonin të legjitimonin institucionet e Republikës së shpallur.

Më 24 maj 1992, në Kosovë u mbajtën për herë të parë zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale shumëpartiake, të organizuara nga institucionet e Republikës së Kosovës. Këto zgjedhje u konsideruan historike, sepse qytetarët, pas disa dekadash, patën mundësinë të votonin lirshëm për përfaqësuesit e tyre dhe jo për kandidatë të imponuar nga pushteti serb.[31]

Megjithëse u zhvilluan nën okupimin ushtarak e policor serb, interesimi i qytetarëve ishte i madh, ata votuan edhe në kushte të rënda, madje edhe nëpër shtëpi private.

Zgjedhjet u organizuan në kushte jashtëzakonisht të vështira, pa prani ndërkombëtare dhe

[31] Xhemail Rexhepi, Gazeta "Bujku", 24 Maj 1992

nën kërcënimin e vazhdueshëm të dhunës serbe, por ato dëshmuan vendosmërinë e qytetarëve për të ndërtuar institucione legjitime në mënyrë paqësore.

Zgjedhjet shërbyen për të konfirmuar pavarësinë e Kosovës, për të injoruar autoritetin e Serbisë dhe për ta ndërkombëtarizuar çështjen e Kosovës.

Ato u konsideruan si një plebishit i dytë popullor, që jo vetëm e përsëriti vullnetin për pavarësi, por edhe e shndërroi këtë vullnet në bazë të një sistemi institucional të brendshëm.

Sipas Fatmir Sejdiut, me votën e tyre, shqiptarët treguan para gjithë botës se kishin të drejtë legjitime. Kjo e drejtë u vërtetua në zgjedhjet shumëpartiake, ku u zgjodh Kuvendi, qeveria plurale dhe kryetari i Republikës së Kosovës.

Me këtë proces, Kosova u pozicionua si subjekt politik me institucione të zgjedhura në mënyrë demokratike, duke e bërë të pamundur injorimin e saj në arenën ndërkombëtare dhe duke dëshmuar se shtetësia e saj tashme kishte marrë formë të qëndrueshme.

Miratimi i ligjit të zgjedhjeve për zgjedhjet e para parlamentare dhe presidenciale si dhe sistemi zgjedhor i përcaktuar me këtë ligj

Pas mbajtjes së Zgjedhjeve të majit 1992 dhe konstituimit të institucioneve të para demokratike, u pa e domosdoshme që procesi zgjedhor të rregullohej përmes një baze ligjore të qartë, në mënyrë që të sigurohej legjitimiteti juridik dhe transparenca institucionale.

Në vitin 1992, Kuvendi i Kosovës miratoi ligjin për zgjedhjet e para parlamentare dhe presidenciale, që u caktuan për 24 maj. Me këtë ligj, u rregullua zgjedhja dhe revokimi i deputetëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës, i deputetëve në Kuvendet e Komunave, si dhe zgjedhja dhe revokimi i Kryetarit të Republikës së Kosovës[32]. Ky ligj kishte për qëllim të forconte pavarësinë e Kosovës dhe të siguronte zgjedhje të lira e demokratike. Ai u konceptua si një hap drejt institucionalizimit të plotë të Republikës së Kosovës, duke i dhënë procesit zgjedhor peshë kushtetuese dhe duke përcaktuar rregulla që reflektonin parimet e demokracive perëndimore.

Ligji parashihte që Kuvendi të kishte 130 deputetë: 100 zgjidheshin me votim të drejtpërdrejtë

[32] Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës 2 korrik 1990 – 2 maj, Prishtinë 2005, f.162

sipas parimit të shumicës, ndërsa 30 sipas sistemit proporcional nga partitë që merrnin mbi 3% të votave. Po ashtu, Presidenti i Kosovës do të zgjidhej nga qytetarët me votim të drejtpërdrejtë.[33]

Një aspekt i rëndësishëm ishte edhe përfaqësimi i të gjitha pakicave kombëtare, duke ua siguruar pjesëmarrjen në Kuvend.

Kjo dispozitë pasqyronte përkushtimin e institucioneve të Kosovës për ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe pluraliste, në kontrast me diskriminimin etnik që ushtronte regjimi serb.

Për organizimin e zgjedhjeve u krijuan tre nivele komisionesh:

- Komisioni Republikan;
- Komisionet zgjedhore të njësive dhe ato të komunave.

Krijimi i këtyre strukturave zgjedhore garantonte mbikëqyrjen institucionale të procesit dhe siguronte një administrim të drejtë e të organizuar të zgjedhjeve.

Sipas F. Sejdiut, thotë se ky ligj shënoi një hap historik për legjitimitetin demokratik të institucioneve të Kosovës, duke garantuar zgjedhjet pluraliste, përfaqësim të pakicave dhe konstituimin e Kuvendit e të Presidencës së Republikës.

[33] B.Stavileci, Gazeta "Bujku", 5 maj 1992, f.3

Caktimi i datës së zgjedhjeve dhe roli i subjekteve politike në organizimin e zgjedhjeve

Pas miratimit te ligjit për zgjedhjet dhe krijimit të institucioneve përkatëse, hapi i radhës ishte përcaktimi i datës së zgjedhjeve, i cili shënoi konkretizimin praktik të procesit demokratik dhe të pavarësisë së shpallur.

Vendosja e datës së zgjedhjeve të 24 majit 1992, shënoi një moment historik për Kosovën, sepse ato u organizuan jo vetëm si proces zgjedhor formal, por edhe si akt politik e kombëtar. Ligji mbi zgjedhjet përcaktoi kushtet e pjesëmarrjes, mënyrën e kandidimit dhe kriteret e vlefshmërisë së procesit, duke i dhënë kështu legjitimitet juridik dhe institucional.

Kjo periudhë karakterizohej nga përpjekja për të ndërtuar institucionet që funksiononin në mënyrë të pavarur nga strukturat serbe, duke i dhënë kuptim real konceptit të Republikës së Kosovës si entitet autonom.

Në këtë kuadër, partitë politike dhe grupet e qytetarëve u përfshinë në përgatitjen e zgjedhjeve, duke u bërë pjesë e një fushate gjithëpërfshirëse, që synonte më shumë unitetin kombëtar sesa rivalitetin partiak.

LDK-ja dhe subjektet tjera politike, theksuan se këto zgjedhje nuk ishin garë klasike për pushtet, por një shprehje kolektive e vullnetit politik të shqiptarëve për të kundërshtuar pushtetin serb dhe për të legjitimuar institucionet e reja të Republikës së Kosovës. Ky mesazh u theksua edhe nga Ibrahim Rugova, pas përfundimit të procesit zgjedhor, i cili deklaroi se "Populli kishte votuar për demokraci, pavarësi dhe neutralitet, duke e parë Kosovën si faktor stabiliteti në Ballkan dhe pjesë të integrimeve evropiane".[34]

Me këtë deklaratë, Rugova përpiqej të paraqiste Kosovën para botës si një subjekt politik të përgjegjshëm, që synonte paqen, stabilitetin rajonal dhe rrugën drejt integrimeve euroatlantike.

Sipas F. Sejdiut, ky qëndrim i Dr. Rugovës do të jetë i rëndësishëm, sepse sipas tij, në pika të shkurtra do të shpaloset esenca e platformës politike jo vetëm lidhur me zgjedhjet, por edhe lidhur me hapat e rëndësishëm që do t'i bëjë Kosova në drejtim të ndërtimit të shtetit të pavarur dhe sovran.

Qëndrimi i tij përmbyllte fazën e konsolidimit të politikës paqësore dhe e orientonte Kosovën drejt shtetformimit institucional, duke e vendosur në binarët e demokracisë dhe të drejtës ndërkombëtare.

[34] Gazeta Bujku "Zekë Gecaj", 24 maj 1992

Organizimi i fushatës zgjedhore dhe mbarëvajtja e saj

Pas caktimit të datës së zgjedhjeve dhe miratimit të ligjit për organizimin e tyre, nisi faza e fushatës zgjedhore, e cila kishte rëndësi të veçantë jo vetëm si aktivitet politik, por edhe si shprehje e hapur e pluralizmit demokratik në Kosovë.

Fushata zgjedhore në Kosovë mund të zgjaste deri 90 ditë dhe mbyllej 24 orë para votimeve. Para zgjedhjeve të 24 majit 1992, ajo përfundoi më 23 maj në orën 07:00.[35] Partitë dhe kandidatët e pavarur prezantuan programet e tyre, duke respektuar rregullat. Kjo fushatë, u pa si një provë e rëndësishme për vendosjen e konkurrencës pluraliste mes partive dhe kandidatëve.

Megjithëse zhvillohej në kushte të jashtëzakonshme politike e nën kërcënimin e vazhdueshëm serb, ajo dëshmoi gatishmërinë e partive dhe qytetarëve shqiptarë për të ndërtuar një sistem politik demokratik e të qëndrueshëm.

[35] B.stavileci, Gazeta "Bujku", 5 maj 1992 f.3

Dita e zgjedhjeve dhe pjesëmarrja e qytetarëve

Pas një fushate të qetë dhe të organizuar mirë, që përfshiu pothuaj të gjitha trevat e Kosovës, erdhi dita e votimit, një ditë që u konsiderua historike për shqiptarët e Kosovës.

Zgjedhjet e para shumëpartiake të 24 majit 1992, për Parlamentin dhe presidentin e Republikës së Kosovës i përshkoi masiviteti, vullneti i madh i votuesve që përmes këtij akti historik të arrihen kërkesat e kahershme të Kosovës, për të krijuar një rend demokratik dhe forcuan *institucionalisht Republikën e shpallur të Kosovës në zhvillime historike*[36]

Ky akt përfaqësonte konkretizimin e plotë të vullnetit politik të shqiptarëve për vetëqeverisje, duke legjitimuar në mënyrë demokratike institucionet e Republikës se Kosovës.

Përkundër kërcënimeve të forcave serbe, mbi 89% e qytetarëve të Kosovës votuan për të zgjedhur Presidentin e Republikës së Kosovës dhe 100 deputetët. 766 068 votues brenda vendit dhe 105 300 në mërgatë. Ibrahim Rugova u zgjodh President i Kosovës, ndërsa LDK fitoi shumicën me 96 vende

[36] Po aty

nga 130 gjithsej. Pjesa tjetër u nda mes partive të vogla dhe kandidatëve të pavarur. Serbët dhe malazezët bojkotuan zgjedhjet, por megjithatë u rezervuan 14 vende për ta.

Rezultatet e zgjedhjeve të 24 majit të vitit 1992, konfirmuan legjitimitetin e institucioneve të Kosovës dhe forcuan pozitën ndërkombëtare të çështjes kosovare, duke dëshmuar se pavarësia e saj tashme kishte bazë popullore, politike dhe juridike.

Pjesëmarrja e delegacioneve të huaja si dhe e medieve në përcjelljen e zgjedhjeve

Vlerësimi ndërkombëtar i procesit zgjedhor të majit 1992 kishte rendësi të veçantë për Kosovën, sepse përmes tij ajo synonte të fitonte njohje dhe legjitimitet në arenën ndërkombëtare, duke treguar se ishte në gjendje të organizonte zgjedhje të lira dhe demokratike.

Zgjedhjet e para parlamentare dhe presidenciale në Kosovë u ndoqën nga një numër i madh gazetarësh dhe delegacionesh të huaja, më i madhi deri atëherë në Kosovë. Mediet ndërkombëtare dhe gazetarët e huaj u impresionuan nga organizimi, vendosmëria dhe qëndrueshmëria paqësore e shqiptarëve.

Raportimet e tyre ndihmuan që opinioni publik ndërkombëtar të njihej më nga afër me realitetin politik e shoqëror të Kosovës, duke theksuar karakterin paqësor të rezistencës shqiptare dhe përkushtimin ndaj demokracisë.

Mark Senoja, gazetar i gazetës franceze *Libération,* i cili për gazetën *Bujku* në Prishtinë tha se: "Pavarësisht gjendjes së jashtëzakonshme dhe represionit serb, te shqiptarët vërehej një shpirt i ri rezistence dhe dëshire për liri."

Ky vlerësim pasqyronte perceptimin e përgjithshëm të mediave evropiane, të cilat filluan ta shihnin Kosovën si një rast të veçantë të emancipimit politik në ish-Jugosllavi.

Zgjedhjet u monitoruan nga rreth tetë grupe ndërkombëtare vëzhguesish nga SHBA, Anglia, Gjermania, Franca, Danimarka, Norvegjia dhe vende të tjera, të cilët i vlerësuan ato si demokratike dhe të organizuara mirë.

Prania e këtyre vëzhguesve shërbeu si garanci për transparencën e procesit dhe ndikoi që zgjedhjet të njiheshin nga shumë organizata ndërkombëtare si një shembull i demokracisë në kushte okupimi.

Pjesëmarrja e delegacionit monitorues nga Kongresi Amerikan, senatorëve evropianë dhe përfaqësuesve të Komitetit të Helsinkit (Erick Syzby), e rriti peshën ndërkombëtare të procesit, ndërsa prania e shumtë e gazetarëve nga Evropa, e bëri këtë ngjarje të pasqyrohej gjerësisht edhe jashtë Kosovës.

Kjo vëmendje ndërkombëtare e forcoi pozitën politike të institucioneve të Kosovës dhe ndihmoi që çështja e saj të fitonte legjitimitet moral e diplomatik, duke e bërë të qartë se populli i Kosovës po ndërtonte institucione mbi parimet e demokracisë dhe vetëvendosjes.

Dhuna e organizuar serbe për të penguar zgjedhjet dhe pasojat e saj

Organizimi i zgjedhjeve në kushte okupimi u shoqërua me tensione të mëdha politike dhe me përpjekje të vazhdueshme të pushtetit serb për ta sabotuar procesin, përmes dhunës, frikësimit dhe presioneve të drejtpërdrejta ndaj qytetarëve dhe aktivistëve shqiptarë.

Zgjedhjet u mbajtën me vendosmëri dhe efikasitet të madh, përkundër organizimit serb për t'i penguar. Në shumë vendvotime kishte ndërhyrje, por ajo që i kishte impresionuar më shumë të huajt, ishte fakti se gjithkund ishin organizuar edhe vendvotimet rezervë, që viheshin në veprim kur policia ndërpriste votimin në vendvotimet e para. Policia i pengoi mjaft votimet duke arrestuar njerëz, por me gjithë këtë organizoheshin nga të tjerët.[37]

Ky nivel përgatitjeje tregoi disiplinën dhe përkushtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, të cilat, pavarësisht pengesave, arritën ta mbajnë procesin nën kontroll dhe ta përfundojnë me sukses.

Dhuna serbe ishte e pranishme edhe në ditët para zgjedhjeve, ku shumë aktivistë shqiptarë u goditën, si vrasja e avokatit Mikel Marku; maltretimi i aktivistëve

[37] Z. H Gazeta "Bujku" 23 maj 1992

të LDK-së Bajram Shala, drejtor i shkollës fillore në fshatin Shalë, Komuna e Lipjanit, dhe Nimon Alimusaj, anëtar i Kryesisë së LDK-së, Dega në Pejë dhe deputet i zgjedhur më vonë. Si dhe maltretimi i shumë aktivistëve të tjerë, të cilët policia serbe i arrestoi me pretekstin se kishin vendosur nëpër qytete pano për zgjedhjet shumëpartiake me portretin e Ibrahim Rugovës. Ata mbaheshin me orë të tëra në stacion të policisë, duke u maltretuar.[38]

Këto veprime të dhunshme kishin për qëllim krijimin e frikës kolektive dhe dështimin e procesit zgjedhor, por në fakt, prodhuan efektin e kundërt, mobilizuan edhe më shumë qytetarët për të marrë pjesë në votime.

Megjithëkëtë, Kosova arriti në fund t'i përfundojë zgjedhjet me sukses. Edhe pse u shoqërua me pengesa, kërcënime dhe arrestime, procesi zgjedhor dëshmoi pjekurinë politike të shqiptarëve dhe vendosmërinë e tyre për të ndërtuar institucione demokratike paqësore. Kjo, në fakt, do të rezultojë si një bumerang për Serbinë më pas, sepse ajo dhunë do të evidentohej nga shumë qarqe ndërkombëtare.

Kjo solli një ndryshim gradual në perceptimin ndërkombëtar ndaj çështjes së Kosovës, duke e

[38] Po aty

paraqitur Serbinë si agresore dhe Kosovën si viktimë të represionit, por njëkohësisht si shembull të rezistencës paqësore dhe demokratike në Ballkan.

KAPITULLI IV

Rëndësia juridike dhe politike e zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992

Ky kapitull trajton dimensionin juridik dhe politik të zgjedhjeve të 2 majit 1992, duke analizuar mënyrën se si ato i dhanë formë shtetësisë së Kosovës dhe krijuan themelet institucionale të saj nën rrethana të okupimit serb.

Zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992 i dhanë legjitimitet shtetit të posashpallur të Kosovës dhe e prezantuan atë si një vend demokratik para botës. Në aspektin juridik, ato përbënin aktin e parë të konfirmimit të sovranitetit popullor pas Deklaratës Kushtetuese të Kaçanikut, duke e shndërruar pavarësinë e shpallur në vullnet të shprehur përmes procesit demokratik.

Këto zgjedhje u panë si dëshmi e vendosmërisë së popullit për të respektuar të drejtat e njeriut dhe konventat ndërkombëtare, edhe pse në kushte shumë të vështira. Për këtë arsye, shpesh janë cilësuar si një "referendum" i përsëritur për pavarësinë e Kosovës.

Në këtë mënyrë, Republika e Kosovës dëshmoi se po ndërtonte themelet e një rendi juridik e politik të bazuar mbi parimet e demokracisë, barazisë dhe vetëvendosjes, në përputhje me Kartën e Kombeve

të Bashkuara dhe aktet ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.

Rëndësia e këtij procesi nuk qëndron vetëm në aktin e votimit, por në pasojat e tij të drejtpërdrejta: krijimin e institucioneve të para të Republikës së Kosovës, të cilat do të përfaqësonin legjitimitetin politik dhe juridik të shtetit të ri.

Formimi i institucioneve të Kosovës dhe puna e tyre në rrethana të okupimit

Pas zgjedhjeve të 24 majit 1992, hapi i radhës ishte formimi i institucioneve të Kosovës, të cilat morën legjitimitet nga mbështetja e gjerë e popullit. Megjithatë, për shkak të kushteve politike dhe okupimit serb, këto institucione nuk mund të funksiononin plotësisht si një shtet i lirë. Për këtë arsye, ato përdorën metoda dhe rrugë alternative për të ofruar shërbime të nevojshme për qytetarët dhe për të përmbushur obligimet e tyre.

Kështu, institucionet e dala nga zgjedhjet e majit 1992, u shndërruan në strukturën themelore të shtetit paralel të Kosovës, duke kombinuar legjitimitetin demokratik me qëndresën politike kundrejt okupimit serb.

Kuvendi i Republikës: pamundësia për të punuar në sesione plenare dhe puna përmes komisioneve

Pas krijimit të institucioneve të para të Republikës së Kosovës, një nga sfidat më të mëdha ishte funksionimi i Kuvendit në kushte të okupimit serb. Megjithëse ai kishte legjitimitet politik dhe juridik nga zgjedhjet e majit 1992, zbatimi praktik i kompetencave të tij u bë pothuajse i pamundur për shkak të represionit dhe kontrollit të plotë serb në territor.

Pas zgjedhjeve të vitit 1992, Kuvendi i Republikës së Kosovës tentoi të konstituohej më 23 qershor, por u pengua nga policia serbe. Megjithatë, ai vazhdoi të punonte nëpërmjet komisioneve parlamentare.

Këto komisione funksiononin në mënyrë të decentralizuar, duke u bërë hallka lidhëse mes Kuvendit, qeverisë dhe strukturave lokale që vepronin në terren.

Sipas prof. F. Sejdiut, kryetar i Kuvendit atë kohë, ishte planifikuar të zgjidhej prof. Anton Çetta, deputet i LDK-së. Rugova dhe LDK-ja fituan legjitimitetin për të ndërtuar institucione paralele, përfshirë edhe një qeveri të udhëhequr nga Bujar Bukoshi në tetor të vitit 1991, e cila vepronte jashtë vendit.

Ky organizim paralel i pushtetit nuk ishte thjeshtë një formë mbijetese politike, por një strategji

e mirëfilltë shtetformuese, e cila synonte ta ruante funksionin e shtetit shqiptar të Kosovës, në mënyrë simbolike dhe praktike deri në kushte të lirisë.

Nevojat bazë të qytetarëve u mbuluan përmes solidaritetit të brendshëm, si mbledhja e mallrave për konsum familjar, si dhe atij të jashtëm, përmes ndihmave financiare nga diaspora. Ky solidaritet u organizua fillimisht nga fondet e LDK-së dhe më pas u formalizua me fondin e Qeverisë së Kosovës, ku diaspora kontribuonte 3% të të ardhurave të saj.[39]

Në këtë mënyrë, lidhja ndërmjet institucioneve politike dhe organizimit qytetar, krijoi një sistem funksional paralel, që i dha Kosovës pamjen e një shteti të strukturuar edhe pse i okupuar.

[39] Buxhovi f.259

Puna e Qeverisë së Republikës dhe qëndrimi i saj jashtë vendit

Pas zgjedhjeve të 24 majit 1992, u formua Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila për shkak të kushteve të okupimit u detyrua të vepronte jashtë territorit të vendit. Kjo qeveri përfaqësonte vazhdimësinë juridike të institucioneve, dalë nga Deklarata Kushtetuese e vitit 1990 dhe ishte shprehje e legjitimitetit të votës së qytetarëve të Kosovës.

Qeveria e Kosovës funksionoi në mërgim (ekzil), sepse pushteti serb e pengoi ushtrimin e saj në Kosovë. Sidoqoftë, ajo shprehu vendosmërinë për të respektuar standardet ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe Parimet e Helsinkit për vetëvendosje. Zgjedhjet, të cilat ishin mbajtur në kushte të vështira, treguan përkushtimin e popullit dhe partive shqiptare. Deputetët e zgjedhur ishin përfaqësues legjitimë, por për shkak të pengesave serbe, parlamenti nuk arriti të konstituohej.[40]

Nëpërmjet kësaj qeverie, Kosova arriti të mbante komunikim të vazhdueshëm me faktorin ndërkombëtar, duke paraqitur dokumente, raporte dhe kërkesa për njohjen e statusit të saj politik. Prania e saj jashtë vendit u bë urë lidhëse midis përfaqësimit diplomatik të çështjes së Kosovës dhe strukturave të rezistencës paqësore brenda vendit.

[40] Dr. Skënder H. Skënderi, "Si veproi Kuvendi i Republikës së Kosovës" vëllimi II-të (20.07.1990-1996), Prishtinë, 2016 f.596.

Organizimi dhe funksionimi i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet

Krahas institucioneve politike dhe qeveritare, sistemi arsimor përbënte një nga shtyllat kryesore të mbijetesës kombëtare të Kosovës gjatë viteve të okupimit. Arsimimi në gjuhën shqipe u shndërrua në formën më të qëndrueshme të rezistencës paqësore dhe ruajtjes së identiteti kombëtar.

Pas mbylljes së shkollave dhe Universitetit në gjuhën shqipe nga Serbia në vitet 1990-1991, shqiptarët organizuan mësimin paralel në shtëpi private, nga fillorja deri në universitet. Arsimi u mbajt falë vetëfinancimit dhe solidaritetit të qytetarëve. Megjithëse nxënësit, studentët dhe arsimtarët u përballën me shtypje e dhunë policore, sistemi paralel arsimor u bë një nga shtyllat kryesore të rezistencës paqësore. Sipas të dhënave të Rexhep Osmanit, kryetar i Lidhjes së Arsimtarëve Shqiptarë, mbi 2280 arsimtarë e nxënës u thirrën në polici, 123 u dënuan me burg, nga pasojat e torturës policore ka vdekur një drejtor shkolle, dy arsimtarë dhe tre prindër, derisa të plagosur kanë qenë 2 prindër dhe 20 nxënës, (nxënësit ishin të gjithë nën moshën 18-vjeçare).[41]

[41] Buxhovi "Kosova 2019". f. 576

Sistemi paralel arsimor dëshmoi se Kosova, edhe pse pa institucione shtetërore funksionale, mbeti e organizuar në mënyrë të pavarur, duke ruajtur kontinuitetin e shtetësisë përmes dijes dhe përkushtimit qytetar.

Organizimi dhe funksionimi i sistemit të financave dhe kontributi 3%

Krahas sistemit politik dhe arsimor, një rol vendimtar në mbijetesën e institucioneve të Republikës së Kosovës gjatë viteve të okupimit e pati organizimi i sistemit financiar. Në mungesë të buxhetit shtetëror, u krijua një mekanizëm i veçantë vetëfinancimi, i cili u mbështet në solidaritetin e popullit dhe kontributin e diasporës.

Në vitin 1992 u themelua Këshilli Qendror për Financim i Kosovës (KQFK), i cili kishte rol vendimtar në mbështetjen e institucioneve të Kosovës gjatë okupimit serb. Ky këshill organizoi financimin e arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe sportit, duke u bërë një shtyllë e rëndësishme e rezistencës paqësore.

Përmes tij, u ruajt funksionaliteti minimal i jetës publike dhe u sigurua që institucionet paralele të mos mbeteshin vetëm struktura politike, por organizma realë që ofronin shërbime për qytetarët.

Financimet u siguruan kryesisht nga diaspora dhe pronarët e ndërmarrjeve private, ndërsa më pas u vendos edhe kontributi 3% i detyrueshëm për shqiptarët jashtë vendit. Përmes këtij fondi u grumbulluan mbi 205 milion marka gjermane, që mbuluan paga, ngritjen e shkollave, ngrohjen dhe shpenzimet tjera.

Një pjesë e mjeteve u depozitua në banka në Gjermani e Zvicër dhe më vonë në "Dardania Bank" në Tiranë.[42]

Kjo mënyrë e menaxhimit transparent dhe e koordinuar financiarisht, e rriti besueshmërinë e institucioneve të Kosovës, duke i dhënë diasporës një rol të drejtpërdrejtë në mbajtjen gjallë të shtetësisë së saj.

Në këtë mënyrë, sistemi financiar i ngritur përmes KQFK-së, dhe kontributit 3% u shndërrua në themelin ekonomik të rezistencës institucionale të Kosovës, duke e bërë atë model unik të vetorganizimit kombëtar në kushte okupimi.

[42] Shih fusnotën 28

Organizimi dhe funksionimi i sistemit të shëndetësisë në vitet ’90 në Kosovë

Në kuadër të institucioneve paralele që u ngritën gjatë viteve të ’90-ta, sistemi i shëndetësor përbënte një ndër shtyllat më humane dhe jetike të mbijetesës së popullit të Kosovës. Ai u organizua në kushte represioni të plotë, kur mjekët dhe personeli shëndetësor shqiptar u përjashtuan nga institucionet shtetërore.

Në periudhën e viteve ’90, pas përjashtimit të mjekëve dhe personelit shëndetësor nga institucionet shtetërore, në Kosovë u organizua një sistem paralel shëndetësor. Mjekët e larguar nga puna iu bashkuan ekipeve mobile që vepronin si ambulanca lëvizëse, duke ofruar shërbime falas për popullatën. Forumi i Gruas së LDK-së dhe Sindikatat e Shëndetësisë organizuan pikat e maternitetit, ekipet e pediatrisë, stomatologjisë dhe shërbime të tjera që vepronin në shkolla dhe hapësira të ndryshme ku kishte nevojë. [43]Financimi dhe mbështetja u siguruan nga fondet e solidaritetit, ndihmat e diasporës dhe të donatorëve.

Këto ekipe funksiononin në kushte minimale, shpesh pa pajisje dhe medikamente, por përmes përkushtimit profesional arritën të mbulojnë nevoja emergjente në shumë zona rurale dhe urbane.

[43] Buxhovi “Kosova” 2019, f. 258-259

Mjekët dhe personeli shëndetësor punuan shpesh në mënyrë vullnetare, pa pagesë dhe pa pajisje elementare mjekësore, duke u mbështetur vetëm te vullneti, solidariteti dhe shpresa për një zgjidhje të shpejtë të çështjes së Kosovës. Ky sistem paralel u institucionalizua përmes Fakultetit të Mjekësisë, duke njohur diplomat dhe duke ruajtur kontinuitetin profesional.

Kjo vazhdimësi profesionale ishte e një rëndësie të jashtëzakonshme, pasi tregoi se edhe në kushte represioni, shëndetësia e Kosovës funksiononte mbi baza etike dhe institucionale, duke ruajtur standarde të kujdesit ndaj pacienteve.

Shërbimi shëndetësor në polikliniken "Nëna Terezë", e cila u hap me iniciativën e Dr. Gani Demollit dhe mjekëve të tjerë më 30 mars 1992, u bë simbol i qëndresës dhe pavarësisë shoqërore, duke u ofruar shërbime mbi 4 milionë pacientëve gjatë tetë viteve.[44]

Ky fakt, dëshmon përmasat e jashtëzakonshme të angazhimit profesional dhe human të mjekëve shqiptarë në periudhën e okupimit.

Pavarësisht propagandës serbe, përmes kontakteve ndërkombëtare dhe të vërtetës në terren, ndihmat

[44] Gani Demolli, "Një luftë më ndryshe" Koha, Prishtinë, Shkurt 2010 f.11

arritën të depërtonin edhe në Kosovë, shpesh me ndihmën e delegacioneve të huaja.[45]

Poliklinika "Nëna Terezë" u bë simbol i humanizmit dhe i qëndresës kombëtare, duke ofruar jo vetëm shërbime mjekësore, por edhe ndihmë sociale dhe psikologjike për familjet e prekura nga represioni.

Gjatë viteve të luftës, personeli shëndetësor, mjekë dhe teknikë, ishin të angazhuar jo vetëm për civilët, por edhe për luftëtarët e UÇK-së, duke organizuar në disa zona edhe spitale mobile.

Ky organizim shëndetësor, i mbështetur në solidaritetin e qytetarëve dhe profesionalizmin e mjekëve, u shndërrua në shembull të jashtëzakonshëm të rezistencës paqësore. Ai ruajti jo vetëm jetën e njerëzve, por edhe dinjitetin e një populli që luftonte për të mbetur gjallë fizikisht dhe shpirtërisht.

[45] Po aty, f.17

Organizimi dhe funksionimi i sistemit të mbrojtjes

Ky ishte momenti kur përpjekjet e popullit të Kosovës për mbijetesë dhe liri morën drejtim të ri, duke u shndërruar nga rezistencë civile në përgatitje të organizuar për vetëmbrojtje.

Ky kalim shënoi një fazë të re të ndërgjegjes kombëtare, ku u kuptua se liria nuk mund të arrihej më vetëm me mjete paqësore, por kërkonte organizim dhe vendosmëri për mbrojtje aktive.

Në kuadër të zhvillimeve që quan drejt organizimit të rezistencës së armatosur, një vend të rëndësishëm zë edhe krijimi i strukturave të para të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe forcave të armatosura të Republikës së Kosovës.

Pas vitit 1990, Qeveria e Republikës së Kosovës në ekzil filloi të shtrinte ndikimin edhe në fusha të tjera, përveç arsimit, si shëndetësia, informimi dhe sidomos organizimi i mbrojtjes.

Këto përpjekje treguan se, pavarësisht mungesës së kushteve dhe përndjekjeve të vazhdueshme, ideja për një organizim të armatosur po piqej në mënyrë të natyrshme brenda shoqërisë kosovare.

Nga viti 1991 deri më 1996, koncepti kryesor ishte "pritja" ose "përgatitja pasive": mbajtja e

forcave policore dhe ushtarake shqiptare në gjendje gatishmërie, pa plan konkret lufte.

Megjithatë, kjo periudhë e "pritjes" shërbeu si bazë për krijimin e strukturave të para që më vonë do të kanalizonin energjinë e popullit drejt një lufte të organizuar për liri.

Stërvitjet e para ushtarake

Nga fundi i vitit 1991 dhe gjatë vitit 1992, disa grupe vullnetarësh kosovarë u dërguan në Shqipëri për stërvitje ushtarake, në bazë të marrëveshjes Rugova-Alia. Në këto kampe morën pjesë qindra vullnetarë, ndër ta edhe figura të rëndësishme të rezistencës, si: Adem Jashari, Sali Çeku dhe Zahir Pajaziti.[46]

Këto trajnime ishin gurthemeli mbi të cilin do të ngrihej struktura e rezistencës së armatosur të Kosovës, duke u dhënë kuptim praktik ideve për vetëmbrojtje dhe përgatitje kombëtare. Të cilët u trajtuan si njësi rezervë deri në fund të vitit 1993 nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës.

[46] Buxhovi, "Kthesa Historike", Prishtinë 2009, f. 223 - 234

Reagimi i Serbisë dhe përhapja e rezistencës

Nga 1993-1994, shumë pjesëtarë të ish-shërbimit policor dhe grupeve të gueriles, u burgosën ose u detyruan të largoheshin nga Kosova.

Adem Jashari, pasi u kthye nga Shqipëria, nisi aksionet e para të armatosura në Kosovë, që më pas u përhapën në Dukagjin e Llap.[47]

Këto aksione shënuan fillimin e një faze të re të rezistencës, ku për herë të parë u konkretizua përpjekja e organizuar për liri.

Rrëfimi i Skënder Zogajt

Këto zhvillime lidhen gjithashtu me disa nga momentet kyçe të formësimit të rezistencës. Ndër këta persona ishte edhe Skënder Zogaj, asokohe i emëruar si zyrtar i Qendrës për Informim të Ministrisë së RK-së. Në rrëfimin e tij, Zogaj shpjegon se përpjekjet për organizimin e mbrojtjes kishin filluar shumë më herët, që në fillim të viteve '90:

"Në vitet '90 u formua Ministria e Mbrojtjes e Kosovës në ekzil me ministër Ahmet Krasniqin dhe më vonë Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK). Për jetësimin e projektit, ministri

[47] Po aty f.492

me ekipin e oficerëve të kabinetit të tij u vendos në Tiranë dhe në maj e qershor të vitit 1997, Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe FARK-u ishin plotësisht të strukturuara".

Ky moment shënonte kalimin nga përpjekjet e shpërndara për rezistencë drejt një organizimi të mirëfilltë ushtarak, me hierarki, njësi dhe përgjegjësi të qarta.

Zogaj përmend se menjëherë pas konsolidimit, u përcaktua edhe destinacioni i parë i trupave të FARK-ut:

"Loxha është destinacioni i parë i njësive ushtarake të FARK-ut që hyjnë në frontin e luftës dhe konfrontohen me forcat e ushtrisë serbe".

Kjo dëshmi e Zogajt mbetet një ndër burimet e rëndësishme për të kuptuar se si u hodhën themelet e para të organizimit të mbrojtjes së Kosovës, shumë përpara shpërthimit të luftës së hapur. Ky organizim institucional dhe ushtarak do të shërbente si bazë për bashkërendimin e mëvonshëm të veprimeve mes strukturave të FARK-ut dhe UÇK-së. Kjo fazë bashkëpunimi mori trajtë të qartë pas marrëveshjes së Oslos, në maj të vitit 1998, duke krijuar një aleancë të përbashkët kundër okupatorit. Por kishte edhe raste kur raportet mes këtyre strukturave tensionoheshin.

* * *

Lufta u shndërrua në përpjekjen e vetme dhe strategjinë më të suksesshme për pavarësinë e Kosovës, e mbështetur edhe nga fuqitë botërore.

Përpjekjet për unifikimin e forcave dhanë rezultate konkrete, ndonëse kishte hapësirë për më shumë bashkëpunim.

Megjithatë, përpara se të vinte deri te organizimi i forcave të armatosura, shoqëria kosovare kishte kaluar nëpër një fazë të gjatë përpjekjesh paqësore, që synonin lirinë me mjete politike e demokratike.

Përpjekjet paqësore nuk mjaftuan përballë represionit dhe dhunës së vazhdueshme serbe. Lufta në Kosovë shpërtheu si pasojë e diskriminimit të gjatë politik, ekonomik e kulturor ndaj shqiptarëve dhe heqjes së autonomisë në vitin 1989 nga regjimi i Millosheviqit. Pas viteve të rezistencës paqësore, në vitin 1997, në funeralin e mësuesit Halit Geci, i cili ishte vrarë nga forcat serbe, Fatmir Sejdiu doli me fytyrë të hapur dhe i dha një mesazh të qartë Serbisë se: "Pavarësisht intensitetit të dhunës dhe terrorit, nuk mund të na ndalin në rrugën e pavarësisë…!"

Aty doli në skenë e maskuar edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ku edhe u paralajmërua se, Serbia do të përballet me forcat e armatosura të Kosovës. Konflikti u shoqërua me masakra, dëbime

masive dhe shkatërrime, duke arritur kulmin në vitin 1999. Pas dështimit të bisedimeve të Rambujesë, NATO ndërhyri më 24 mars 1999 me bombardime kundër caqeve serbe. Pas 78 ditësh, forcat serbe u tërhoqën nga Kosova më 12 qershor 1999, duke i hapur rrugë vendosjes së administratës së OKB-së dhe trupave të KFOR-it. Lufta solli mbi 13 000 viktima shqiptarë dhe qindra e mijëra refugjatë.

Pas gjithë atyre viteve vuajtje, dhune e rezistence, liria filloi të marrë formë nëpër beteja të vështira dhe njerëz që nuk u dorëzuan.

Rrëfimi i Anton Qunit

Ndër figurat dhe ngjarjet që shënuan kthesë ishte edhe Anton Quni, i cili, me vendim të ministrit Ahmet Krasniqi, mori detyrën e komandantit të një njësie të veçantë. Kujtimet e tij nga ajo kohë sjellin një pamje të gjallë se si struktura shtetërore e ndërtuar në ekzil po përkthehej në veprim konkret në kufi e në betejë.

Ai tregon rrugëtimin e njësisë se tij nga Beteja e Koshares, për përgatitjet, sakrificat dhe njerëzit që dhanë gjithçka për lirinë e vendit.

Në bisedën tonë, ai rikujton se më 7 korrik 1998 ishte emëruar komandant i Batalionit Diverzanto-Vëzhgues (BDV) nga Ministri i Mbrojtjes, kolonel Ahmet Krasniqi. Nën urdhrat e të cilit vepronte drejtpërdrejt.

"Misioni ynë, - thotë Quni - ishte mbledhja e informatave për kapacitetet e forcave ushtarake serbe në brezin kufitar Shqipëri-Kosovë dhe po ashtu si Vizion i ministrit Krasniqi ishte që kjo njësi të shërbente edhe për sigurinë e Ministrisë së Mbrojtjes, sapo ajo të vendosej në Kosovë".

Ai shpjegon se puna e tyre kërkonte vigjilencë, durim dhe rrezik të vazhdueshëm. Informacionet e mbledhura ishin jetike për planifikimin e operacioneve të ardhshme dhe për organizimin e mbrojtjes.

Në vijim, Quni shton:

"Kishim arritur të kryenim 23 vëzhgime brenda Kosovës dhe informacionet e mbledhura i dërgonim në Ministrinë e Mbrojtjes, të paktën një herë në javë. Këtë detyrë e vazhduam deri më 9 prill 1999".

Pas kësaj periudhe, Batalioni Diverzanto-Vëzhgues u përfshi në një formacion më të madh, Grupi Operativ 3 (GO-3), i udhëhequr nga komandanti Rrustem Berisha".

Sipas Qunit:

"Në përbërje të GO-3 ishin njësitë: Brigada 131, Brigada 134 dhe BDV. Më 11 maj 1999, ky grup u emërua Brigada 138 "Agim Ramadani". Ky formacion mori përsipër një nga operacionet më komplekse të UÇK-së, i njohur si "Beteja e Koshares".

Gjatë kësaj beteje, u vranë 114 luftëtarë, përfshirë komandantët e shquar Sali Çekaj, Agim Ramadani, Xhemajl Fetahaj dhe Abaz Thaçi.

Humbja e tyre la gjurmë të pashlyeshme në kujtesën e të gjithë bashkëluftëtarëve, përfshirë edhe Anton Qunin, i cili ndan një moment për librin "Zëri që s'u fik" dhe i cili moment, ishte më emocionali i asaj kohe:

"Një moment i veçantë gjatë këtij operacioni ishte kur, pas luftimeve të ashpra, arritëm ta neutralizonim armikun në të gjitha pozicionet e zjarrit dhe të merrnim nën kontroll objektin ushtarak të njohur si Karaulla e Koshares. Më 10 prill 1999, nga shtiza e flamurit u hoq flamuri i Serbisë dhe, me një ceremoni ushtarake plot emocione, u ngrit flamuri kombëtar me shqiponjën dy krenare, i cili vazhdon të valojë edhe sot".

Ky kujtim që ai rrëfen me zë të qetë, por me ndjenjë të thellë, mbetet simbol i fitores dhe i sakrificës së përbashkët. Në zërin e tij, ndihet ende jehona e asaj dite dhe krenaria që flamuri kuq e zi u ngrit në vendin ku filloi liria.

Mbarimi i luftës

Lufta e Kosovës shënoi jo vetëm fundin e një epoke të gjatë shtypjeje, por edhe fillimin e një periudhe të re të historisë së saj moderne. Mbarimi i saj solli jo vetëm çlirimin e vendit, por edhe sfidat e rindërtimit dhe të shtetformimit.

Përfundimi i Luftës në Kosovë, më 12 qershor 1999, ishte rezultat i rezistencës politike, asaj të armatosur dhe i ndërhyrjes së NATO-s, që hapi një etapë të re për emancipim politik e shoqëror. Ky moment, i shoqëruar me kujtimet e dhimbshme për viktimat e terrorit shtetëror serb dhe shkatërrimin pothuajse tërësor të vendit, u bë njëkohësisht simbol i shpresës që sjell liria. Megjithëse Kosova mbeti pa infrastrukturë ekonomike, pa institucione shtetërore funksionale, pa rrymë, pa polici, pa regjistra kadastralë, pa regjistra civilë dhe me vendbanime të rrënuara, vendosmëria e qytetarëve u shndërrua në themelin e rindërtimit të jetës dhe të institucioneve.[48]

Pas luftës së vitit 1999, nën administrimin e UNMIK-ut dhe mbikëqyrjen e OSBE-së, u organizuan zgjedhjet e para lokale në Kosovë më 28 tetor 2000. Në këto zgjedhje, LDK-ja (Lidhja

[48] Fatmir Sejdiu – Ora e Kosovës, (Pavarësia dhe shtetndërtimi), 2024, f.13

Demokratike e Kosovës) e Ibrahim Rugovës fitoi bindshëm, duke marrë shumicën absolute, në pothuajse të gjitha komunat dhe duke u konfirmuar si forca kryesore politike në Kosovën e pasluftës.

Liria që u fitua me sakrifica të mëdha duhej të sillte paqe, por ajo nuk arriti menjëherë. Kosova e pasluftës u përball me ndasi të reja, me luftëra të brendshme për pushtet dhe me plagë që hapeshin nga vetë shqiptarët, apo më mirë të themi nga mbetjet ideologjike të Serbisë. Profesor Fatmir Sejdiu e përshkruan këtë periudhë me tone të trishta kur thotë:

"Përpos vuajtjeve nga lufta, të cilën do ta përjetojë populli i Kosovës për disa vite rresht, dhimbjen e tij e shtuan edhe vrasjet e veprimtarëve politikë dhe luftëtarëve për lirinë e Kosovës në periudhën e pasluftës. Vrasjet e tilla shkaktuan dhimbje të përhershme për familjet dhe gjithë miqtë e tyre, e në të njëjtën kohë ishin goditje edhe në përpjekjet për ndërtimin e institucioneve demokratike të vendit në një atmosferë paqeje publike. Në serinë e këtyre ngjarjeve dhe akteve kriminale u vranë figura të shquara intelektuale e politike, si Xhemail Mustafa, njeriu i urtë dhe intelektuali i pashembullt, me vlera të larta njerëzore." [49]

Derisa po lexoja këtë që e thotë prof. Sejdiu, ndihem thellësisht keq që pas luftës, kur plagët e

[49] Po aty, f. 33

popullit tonë nga armiku serb ende ishin të freskëta, pati njerëz që menduan të arrinin poste politike përmes dhunës, duke eliminuar kundërshtarët e tyre. Këto akte kriminale, jo vetëm që dëmtonin shoqërinë dhe demokracinë në zhvillim, por shkatërronin edhe jetë njerëzish të pafajshëm. Dhimbjen për këto ngjarje e kam përjetuar edhe vetë, sepse më kanë vrarë vëllain, Liridonin-19 vjeç, më 29 qershor 2006, i cili ishte mbështetës i LDK-së, por njëkohësisht edhe student në vitin e parë të Drejtësisë, në Universitetin "Hasan Prishtina" në Prishtinë. Ai i donte njerëzit por nuk e donte padrejtësinë, prandaj dëshironte të studionte në këtë drejtim. Kjo plagë personale më bëri të kuptoj më thellë se sa e padrejtë dhe e rëndë ka qenë kjo periudhë për familjet që humbën më të dashurit e tyre.

Në librin e tij "Ora e Kosovës", Fatmir Sejdiu përshkruan periudhën vendimtare të viteve 2005-2006, kur Kosova po hynte në fazën përfundimtare të përgatitjeve për pavarësi. Ai tregon se procesi i bisedimeve me Serbinë ishte paralajmëruar dhe pritej të fillonte së shpejti, duke shënuar një hap historik për të ardhmen politike të vendit. Megjithatë, në këtë kohë kritike, vendin e goditi lajmi për sëmundjen e rëndë të presidentit Ibrahim Rugova, krijuesit të identitetit politik dhe shtetëror të Kosovës.

Edhe pse i sëmurë, Rugova u shfaq para qytetarëve me një mesazh të fuqishëm shprese e vendosmërie:

"Qytetarë të dashur, jam i bindur se me ndihmën e Zotit do ta kapërcej edhe këtë betejë dhe do të vazhdojmë të punojmë së bashku më fuqishëm për njohjen e pavarësisë së vendit tonë, Kosovës, nga miqtë tanë amerikanë dhe evropianë. Pres përkrahjen tuaj, si gjithmonë. Zoti ju bekoftë! Zoti i bekoftë miqtë e Kosovës! Zoti e bekoftë Kosovën!" [50]

Fatmir Sejdiu e vlerësonte Rugovën si figurë të jashtëzakonshme, ku ndër të tjera thekson:

"Në këtë gjendje të rëndë shëndetësore të presidentit Rugova, do të bëheshin edhe përgatitjet për të ndërtuar formacionet prezantuese të Kosovës për të filluar procesin e bisedimeve me Serbinë" [51]

Në përfundim, Sejdiu thekson se vdekja e presidentit Ibrahim Rugova në fillim të vitit 2006 ishte një humbje e madhe për Kosovën, pikërisht në momentin kur po përgatitej hapja e bisedimeve vendimtare për statusin e saj. Megjithatë, mesazhi i Rugovës mbeti si një testament politik dhe moral për të gjithë qytetarët dhe klasën politike, duke i dhënë forcë procesit që do të përfundonte me shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.

[50] Sejdiu, f.44
[51] Po aty, f.45

Pas vdekjes së Presidentit Ibrahim Rugova në janar të vitit 2006, pozitën e kreut të shtetit e mori Fatmir Sejdiu. Ai e përshkruan atë moment si një barrë të rëndë emocionale dhe historike:

"Frikë nuk kisha, shqetësim po. Para meje sa hapeshin dhe mbylleshin tablo të shumta kujtimesh për rrugët e kaluara si popull dhe si vend. I veçantë ishte kujtimi me respekt dhe dhimbje për presidentin Rugova dhe për shumë njerëz që trimërisht u sakrifikuan për lirinë dhe shkuan me mallin e saj nga kjo botë" [52]

Fatmir Sejdiu e mori këtë përgjegjësi, duke e konsideruar si amanet politik të Rugovës, të cilin e çoi në fund me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Më 17 shkurt 2008, në seancën solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me rastin e shpalljes së Kosovës shtet sovran dhe i pavarur, ai iu drejtua të pranishmëve dhe qytetarëve me një fjalim ku thotë:

"Sot, kujtojmë shumë sakrifica që i kanë paraprirë kësaj dite të jashtëzakonshme. I kujtojmë nënat dhe baballarët të cilët përjetuan vështirësi të papërshkrueshme në mënyrë që bijtë dhe bijat e tyre të mund të jetonin të lirë. Sot, kujtojmë Presidentin Ibrahim Rugova, udhëheqësin e madh dhe themeltarin e shtetit tonë, i cili e nxori Kosovën nga kaosi

[52] Sejdiu, f.60

në rend demokratik. Sot, kujtojmë Adem Jasharin dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës që e çuan tutje vullnetin e popullit të Kosovës për të qenë të lirë. Po ashtu kujtojmë edhe fqinjët tanë të të gjitha përkatësive etnike, ideologjike e religjioze, të cilët na dolën në ndihmë gjatë viteve të represionit dhe luftës. I kujtojmë të gjitha këto, jo në shenjë hakmarrjeje për të kaluarën e dhunshme, por për të ndërtuar një të ardhme plot besim që do të ofrojë ambient për pajtim dhe falje. Këto ngjarje të madhërishme të historisë sonë, sakrificat tona, si dhe shpresat dhe arritjet tona, na kanë sjellë sot këtu për të shpallur pavarësinë tonë. Kjo shpallje e pavarësisë është vullnet i popullit[53]"

Ngjarjet e përshkruara tregojnë qartë se rruga e Kosovës drejt lirisë dhe shtetësisë ka qenë e gjatë dhe e mbushur me sfida. Ajo nuk u ndërtua brenda natës, por me përpjekje të vazhdueshme, me sakrifica të mëdha dhe me vendime të guximshme politike që shpesh u morën në rrethana shumë të vështira. Procesi i krijimit të institucioneve, organizimi i jetës politike dhe sociale nën shtypje, si dhe rezistenca paqësore e më pas edhe nga përballja e armatosur, tregojnë se populli ynë nuk u dorëzua përballë padrejtësive.

Këto zhvillime dëshmojnë se pavarësia e Kosovës nuk ishte rezultat i rastësisë apo i ndihmës së jashtme

[53] Sejdiu, f.251

të momentit, por fryt i një rruge të gjatë, i një vullneti të pathyeshëm dhe i një sakrifice të përbashkët. Ai na kujton gjithashtu se arritjet e sotme kanë një çmim të lartë dhe se detyra jonë është të mos e harrojmë këtë çmim, por ta respektojmë dhe ta mbrojmë duke e forcuar më tej shtetin dhe demokracinë.

Përfundimi

Duke u mbështetur në këto zhvillime historike dhe përpjekjet e pandalshme të popullit të Kosovës, në pjesën përmbyllëse të këtij libri kam synuar të jap një pasqyrë të qartë të rrugës drejt shtetformimit dhe pavarësisë.

Falë mbështetjes dhe udhëzimeve të profesor Fatmir Sejdiut, të cilin njëkohësisht edhe e falënderoj, në pjesën e dytë të këtij libri kam rindërtuar dhe pasqyruar ngjarjet më të rëndësishme historike që shënuan sakrificat, mundimet dhe përpjekjet e shumta të popullit të Kosovës, për të vendosur themelet e shtetit të Republikës së Kosovës. Këto sakrifica ishin të mëdha dhe të vazhdueshme, duke filluar nga protestat e shumta të organizuara, rezistencat e njëpasnjëshme, deri te grevat e minatorëve, të cilat u zhvilluan si kundërpërgjigje ndaj regjimit të Millosheviqit. Ky regjim, përmes ndryshimeve kushtetuese, synonte ta shtrinte pushtetin serb mbi gjithë territorin e Kosovës.

Të gjitha këto ngjarje të fundviteve '80 dhe fillimviteve '90 janë trajtuar në mënyrë kronologjike, duke filluar me miratimin e Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut të vitit 1990 nga përfaqësuesit shqiptarë. Kjo deklaratë hodhi poshtë amendamentet e

miratuara nga Serbia një vit më parë, të cilat cenonin rëndë pozitën e shqiptarëve. Në vazhdim, kjo hapi rrugën për miratimin e Kushtetutës së Kaçanikut më 7 shtator 1990, që shënoi themelimin e parë institucional të Republikës së Kosovës.

Në këtë përmbledhje është trajtuar gjithashtu edhe çështja e referendumeve, si veprime ideo-politike që dëshmonin orientimin e qartë të shqiptarëve drejt shtetësisë dhe pavarësisë. Nën udhëheqjen e Ibrahim Rugovës, me durim dhe zgjuarsi, u ndoq një rrugë paqësore, që kishte për qëllim shmangien e luftës dhe parandalimin e gjenocidit, si ai që kishte ndodhur më parë në Bosnjë e Hercegovinë.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm, ishte edhe përpjekja për të ndërtuar institucione paralele, të cilat funksionuan "nën hije" pas formimit të Qeverisë së Kosovës. Këto institucione u mbështetën nga fondet e diasporës, duke mundësuar financimin e arsimit, shëndetësisë, skemave sociale dhe shërbimeve mbrojtëse.

Nga të gjitha këto zhvillime, zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të 24 majit të vitit 1992, përbëjnë momentin më kulmor. Ato ishin zgjedhjet e para pluraliste dhe demokratike në Kosovë, të mbajtura në rrethana tepër të vështira, por me një pjesëmarrje të jashtëzakonshme qytetare, që dëshmon vendosmërinë për liri dhe pavarësi. Këto

zgjedhje, për nga pesha dhe rëndësia, mund të konsiderohen si një referendum i dytë pas atij të vitit 1991, duke vulosur përfundimisht qëndrimin politik të shqiptarëve të Kosovës.

Rëndësia e tyre qëndron jo vetëm te vetë fakti i mbajtjes së zgjedhjeve, por edhe te mënyra e organizimit, gara demokratike dhe garancitë për përfaqësimin e komuniteteve pakicë, që vendosën themelet e pluralizmit politik në Kosovë. Sipas ligjit, sistemi zgjedhor i kombinuar siguroi 100 vende të ndara sipas shumicës dhe 30 vende të ndara sipas proporcionalit (me prag), duke krijuar një bazë të qëndrueshme institucionale.

Si rezultat, u themelua zyrtarisht (konstitua) Kuvendi i Republikës dhe u formuan institucione të rëndësishme, të cilat, pavarësisht presionit dhe rrethanave të rënda, arritën të ushtronin veprimtarinë e tyre. Ky vullnet i madh qytetar dhe politik ishte themeli mbi të cilin u ndërtua më vonë shteti i pavarur dhe sovran i Kosovës.

ALBUMI

FOTOGRAFI DHE FJALË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMISIONI QENDROR I STATUSIT
"DËSHMORI I ATDHEUT"

ÇERTIFIKATË
E DËSHMORIT TË ATDHEUT

Komisioni Qëndror i Statusit "Dëshmorë i Atdheut"
me Vendimin Nr. 636, datë 22.11.2012
shpall "Dëshmor i Atdheut"
HALIL HAXHIA
dhe familjes së tij i jep simbolin
"Familje e Dëshmorit të Atdheut"

KRYETARI
MINISTRIT MBROJTJES

ORIT TË ATDHEUT

ATDHEUT"

në datë 09.11.2012, në
mbështetje të nenit 2 dhe 4 të Ligjit nr. 8607 datë 27.04.2000, Statusi i "Dëshmorit të
Atdheut", i ndryshuar, dhe të Vendimit nr. 151, datë 25.04.2002 për Statusin "Dëshmor i
Atdheut", i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, mori në shqyrtim kërkesën që i përket
Ministrisë së Forcës dhe Sigurisë së Kosovës.

Pasi shqyrtoi kërkesën e Ministrisë së Forcës dhe Sigurisë së Kosovës, dokumentacionin
bashkëlidhur, materialet shkresore të ndodhura në dosjen nr. .

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës dhe dhënien e Statusit "Dëshmor i Atdheut", për shtetasin Halil HAXHIA.

2. Dhënien e simbolit "Familje e Dëshmorit të Atdheut", kërkuesit Ministrisë së Forcës dhe Sigurisë së Kosovës.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim prane Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall sot më datë .11.2012

KRYETARI

ARBEN IMAMI

MINISTËR I MBROJTJES

Certifikatë e dëshmorit të atdheut e dhënë nga Shteti
i Shqipërisë për katragjyshin Halil Haxhia,
me rasitn e 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë
(22.11.2012)

Pllaka përkujtimore kushtuar Parisë së Drenicës

Katragjyshi Halil Haxhia së bashku me 11 shokët e tij të pushkatuar më 16 Nëntor 1912, tek Ura e Podrançës, në hyrje të Vushtrrisë

Me bacin Jakup 01.11.2016

Gjyshi, Isuf Halilaj në vitin 1990

Mehmet Halilaj
(baci Mehë 2016)

Babi, me shokun e tij të luftës
Bashkim Spahiu

Axha Rrahim Halilaj, me uniformën
e tij të luftës (2002)

Liridon Halilaj,
Viti 2005

Nëna dhe babai im, janar 1998

Unë në mes, me vëllain dhe motrën, viti 2003

Shtëpia e vjetër e djegur më 27-29 mars të vitit 1999

Gjatë konsultave rreth temës së diplomës me Fatmir Sejdiun,
në Kuvendin e Kosovës (23.02.2021)

PËRMBAJTJA

Hyrje 5
PJESA E PARË **7**
Para se të fillonte lufta 9
Fillimi i luftës 11
Vrasja e mësuesit Haxhi Beka 16
Momentet kur askush nuk dinte çfarë të bënte 19
10 Prill - Dëbimi për Shqipëri 31
11 prill - Ecja nëpër shi 34
12 prill - Dita e zhgënjimit 36
13 prill - Kalimi i kufirit 39
Qëndrimi në Kampet e Librazhdit - Togëz, në Shqipëri 43
Rrëfimet e Bacit Jakup 45
Dëbimi për Maqedoni 52
Kthimi në Kosovë 55
Përjetimi i luftës nga ata që qëndruan në Kosovë 57
PJESA E DYTË **61**
Hyrje e pjesës së dytë 63
KAPITULLI I **65**
Tensionet politike dhe shpërbërja e Jugosllavisë 67
Shembja e pozitës kushtetuese të Kosovës nga Serbia 71
Themelimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, dhjetor 1989 78

KAPITULLI II **81**
Kuvendi i Kosovës nga Rezistenca Politike deri në shpalljen e Pavarësisë se Kosovës - 02.07.1990 83
Miratimi i Kushtetutës së Kosovës më 7 shtator 1990 dhe rëndësia e saj juridike e politike 85
Organizimi dhe mbajtja e Referendumit për Pavarësinë e Kosovës, 26-30 shtator 1991 87
Rëndësia politike dhe pesha ndërkombëtare e referendumit si dhe përputhja kohore e tij me referendumet e ngjashme 90
KAPITULLI III **95**
Organizimi i zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale në Kosovë më 24 maj 1992; pesha dhe rëndësia e tyre juridike-politike dhe historike 97
Miratimi i ligjit të zgjedhjeve për zgjedhjet e para parlamentare dhe presidenciale si dhe sistemi zgjedhor i përcaktuar me këtë ligj 99
Caktimi i datës së zgjedhjeve dhe roli i subjekteve politike në organizimin e zgjedhjeve 101
Organizimi i fushatës zgjedhore dhe mbarëvajtja e saj .. 103
Dita e zgjedhjeve dhe pjesëmarrja e qytetarëve 104
Pjesëmarrja e delegacioneve të huaja si dhe e medieve në përcjelljen e zgjedhjeve 106
Dhuna e organizuar serbe për të penguar zgjedhjet dhe pasojat e saj 108

KAPITULLI IV **111**
Rëndësia juridike dhe politike e zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992 113
Formimi i institucioneve të Kosovës dhe puna e tyre në rrethana të okupimit 115
Kuvendi i Republikës: pamundësia për të punuar në sesione plenare dhe puna përmes komisioneve 116
Puna e Qeverisë së Republikës dhe qëndrimi i saj jashtë vendit 118
Organizimi dhe funksionimi i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet 119
Organizimi dhe funksionimi i sistemit të financave dhe kontributi 3% 121
Organizimi dhe funksionimi i sistemit të shëndetësisë në vitet '90 në Kosovë 123
Organizimi dhe funksionimi i sistemit të mbrojtjes 126
Reagimi i Serbisë dhe përhapja e rezistencës 128
Mbarimi i luftës 134
Përfundimi 141

KUSHTRIM HALILAJ

ZËRI QË S'U FIK

Përjetime - Kujtime - Analiza studimore

Korrektor
Autori

Përgatitja kompjuterike
URAdesign

Prishtinë, 2025

Katalogimi në botim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës
"Pjetër Bogdani"

821.18-94

Halilaj, Kushtrim

Zëri që s'u fik : përjetime - kujtime - analiza studimore / Kushtrim Halilaj. - Prishtinë : Ura, 2025. - 156 f. : ilustr. ; 20 cm. - (Biblioteka Oaza e leximit)

ISBN 978-9951-784-89-4